



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim
Agrobiznesi”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”,
Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asoc. Edmond Kadiu

2. Prof. Asoc. Elena Kokthi

Korrik / 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” ofruar nga Institucioni
i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë (UK)
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Bujqësisë (FB)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Menaxhim Agrobiznesi (MA)
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR nr.261, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 851, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	• 2021- 2022/ 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 3 PAK • 2022- 2023/ 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 3 PAK • 2023- 2024/ 13 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 2 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2021-2022 5 studentë Viti 2022-2023 4 studentë Viti 2023-2024 20 studente
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Fan S.Noli” Korçë më tej UK, është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. UK është liçencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 230, datë 29.05.1992 dhe është riorganizuar me VKM Nr 213, datë 24.05.1994”.

IAL UK është organizuar në 4 Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë; Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane dhe Fakulteti i Bujqësisë (FB). Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” ofrohet nga Fakulteti i Bujqësisë.

Fakulteti i Bujqësisë është i përbërë nga tre departamente:

1. Departamenti i Agrobiznesit
2. Departamenti i Agronomisë
3. Departamenti i Agroushqimit

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UK dhe Rregullorja e programit të studimit.

Stafi i angazhuar në këtë program studimi (PS) është i përkushtuar dhe posedon eksperiencën e nevojshme për të ofruar një shërbim cilësor. Programi i studimit synon të përgatisë specialistë të kualifikuar në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe agrobiznesit. Në këtë kontekst ky program studimi ka një rëndësi strategjike në zhvillimin e bizneseve bujqësore në rajonin në fjalë edhe me gjerë. Megjithatë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme sidomos sa i përket standardit të krediteve të praktikës, ngarkesës mësimore të pedagogëve, moduleve që lidhen me menaxhimin e burimeve natyrore si një nevojë e kohës, etj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Agrobiznesi” ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit (Fakulteti i Bujqësisë) pranë IAL UK filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.


Vizita 2 ditore në IAL UK u realizua gjatë datave 29-30 Prill 2024 , ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ u takua me: Dekanin e FB dhe Përgjegjës të Departamentit, me Zyrën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe stafin e sekretarisë mësimore.

Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc Erjon Xhako.

Më datë 09.07.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 93/18 Prot., datë 10.07.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 12.07.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 1688/1 Prot., datë 12.07.2024, institucioni ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formën përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.



Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë (UK), ofron programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndyshuar. Programi i studimit Bsc “Menaxhim Agrobiznesi” ofrohet nga Departamenti i Agrobiznesit, në Fakultetin e Bujqësisë (FB). Programi i studimit nën vlerësim, është rishikuar vazhdimisht në përputhje me dinamikën e zhvillimeve bashkëkohore dhe legjislacionin në fuqi. Programi i studimit Bachelor “Menaxhim Agrobiznesi” është riorganizuar me Urdhër të MAS nr. 261, datë 19.07.2021, “Për riorganizimin e programit të ciklit të parë të studimit (bachelor) në “Menaxhim Agrobiznesi”” në përputhje me nivelin 6 të kornizës shqiptare të kualifikimit. Programi Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” realizohet me 180 kredite dhe ofrohet në gjuhën shqipe. Ai zhvillohet në kohëzgjatje normale në 3 vite akademike, me 6 semestra. Synimet kryesore të programit të studimit janë, përgatitja e specialistëve të kualifikuar në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe agrobiznesit. Kjo është evidentuar në Statutin dhe rregulloren e UK, Rregulloren e Fakultetit të Bujqësisë dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UK 2022-2027. Në këto evidenca theksohet se institucioni ofron programe studimi që kanë për qëllim të mbështesin prioritetet strategjike të vendit përmes formimit e kualifikimit të specialistëve të lartë të fushës së agrobiznesit në përputhje me vlerat akademike kombëtare. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UK</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i studimit është hartuar në përputhje me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe në përputhje me qëllimin dhe misionin e UK, të shprehur në Statutin e tij. Këtu gjejmë të përcaktuar se UK synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	akademike, përmes nxitjes së lirisë akademike, kërkimit shkencor, dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare, duke u bërë kontribues në formimin e profesionistëve të rinj në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare. Në përmbushje të misionit, GVJ konstaton se UK dhe Fakulteti i Bujqësisë mbështet programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznes” me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore bazuar në dokumenta strategjike të insitucionit. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë “Departamenti i Agrobiznesit”.</i> <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Rregullorja e UK më konkretisht Neni 45-46 i që lidhet me programet e studimit të ciklit të parë bachelor paraqet përcaktimet rregulluese që janë të lidhura me programet e studimit, organizimin në kredite, formën e zhvillimit në përputhje me dokumentat strategjike të IAL-së. <i>Ev 1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev 1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Ev 1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK</i> <i>Ev 2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev 2.3 Rregullore e njësisë bazë “Departamenti i Agrobiznesit”.</i> <i>Ev 2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Fakultetit të Bujqësisë, si dhe fushën akademike të Departamentit të Agrobiznesit. Ky i fundit përpos programit të studimit të ciklit të parë në Menaxhim Agrobiznes, ofron edhe programit të studimit profesional, në Menaxhim Biznesi Bujqësor si dhe dy programe studimi në ciklin e dytë “Master Profesional në Drejtim Agrobiznesi” dhe “Master Profesional në Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” <i>GVJ gjykon që katër programet e studimit të lartpërmendura janë një mundësi e mirë për të ofruar një qasje holistike të kompetencave që ofrohen nga njësia bazë. Kjo do të thotë që stafi i angazhuar në këto programe studimi ka një vizion më të gjerë se si duhet të implementohen modulet në përputhje me nevojat e ndryshme të studentëve në të tre ciklet (profesional, bachelor dhe master). Kompetencat e ofruara në nivelin ciklin e parë dhe të dytë mund ti shërbejnë stafit të përfshirë në</i>

	<i>programin e studimit për të ofruar një qasje me praktike. Nga takimi i GVJ-së me drejtuesin e njësisë bazë si dhe stafin e angazhuar në programin e studimit u vu re disponibiliteti për të përshtatur vazhdimisht përmbajtjen e programit të studimit me elementë praktikë të zhvillimit të biznesit bujqësor.</i> Një element tjetër për tu përmendur dhe që mund të ndikojë në cilësinë e programit të studimit dhe qëndrueshmërinë e tij në të ardhmen është përfshirja e stafit të angazhuar në projekte ndërkombëtare si DUALFS, SMART-AL etj. Projekte të cilat lidhen kryesisht me ngritjen e kapaciteteve në Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund të ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së njohurive të lidhura me biznesin bujqësor duke i dhënë atij karakteristika unike në vend dhe duke e bërë më kompetitiv edhe në rang kombëtar. <i>Ev 2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021</i> <i>Ev 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Siç u përmend më lart, programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznes” ofrohet nga Departamenti i Agrobiznesit, i cili është pjesë e Fakultetit të Bujqësisë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë. Rregullorja e programit të studimit është në përputhje me fushat didaktike dhe të kërkimit të programit nën njësinë kryesore, Fakulteti i Bujqësisë. Departamenti i Agrobiznesit ofron programin e studimit “Menaxhim Agrobiznes” në ciklin e parë Bachelor, Diplomë profesionale si dhe dy programe studimi në ciklin e dytë Master për të thelluar njohuritë dhe specializimin e studentëve. Objektivat e njësisë kryesore, Departamentit të Agrobiznesit janë evidentuar si vijon: • Të përgatisë specialistë të kualifikuar dhe të aftë të përballen me sfidat e kohës për të drejtuar dhe menaxhuar ndërmarrje agrobiznesi dhe për të garantuar politika bashkëkohore të Zhvillimit Rural në Rajon dhe më gjerë. • Të përgatisë specialistë të kualifikuar dhe të aftë për Integrimin e bujqësisë nga një bujqësi artizanale në një bujqësi të mbështetur në industri dhe shërbime për tu bërë ballë sfidave të një konkurrence globaliste. • Të përgatisë specialistë të kualifikuar dhe të aftë për shfrytëzimin dhe manaxhimin e burimeve natyrore dhe vënien e tyre në interes të prodhimit dhe rritjes së të ardhurave. • Të përgatisë specialistë të kualifikuar dhe të aftë për përmirësimin dhe transformimin e strukturave prodhuese, për të mundësuar

	kalimin e fermave shqiptare nga faza e prodhimit për vetëkonsum në atë me qëllim fitimi dhe orjentimi nga tregu. Të nxisë aktivitete mësimore e kërkimore dhe të zhvillojë bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mësimit dhe kërkimit në interes të institucionit dhe vendit tonë. Veprimtaria akademike e UK zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi në kodifikimin e programeve të studimit. IAL ka propozuar kodin si vijon për programin e studimit në shqyrtim, "Menaxhim Agrobiznes" 63 BA0413S. <i>Ev.1.3. Plani Strategjik i Zhvillimit UK</i> <i>Ev 2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev 2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev 2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i> <i>Ev 2.5.1: Shkrese nr.144 prot. date 26.01.2023 "Per kodifikimin e programeve te studimit".</i> https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fbu&tipi=ba			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UK ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit. Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Agrobiznes" është në koherencë me strategjinë afatgjatë të institucionit për sa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	Mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit bazohet tek Statuti i UK, Rregullorja e Fakultetit të Bujqësisë, Rregullorja e Departamentit të Agrobiznesit si dhe tek Rregullorja e programit të studimit, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë. Fakulteti i Bujqësisë ka ngritur marrëdhënie bashkëpunimi midis departamenteve për të siguruar ecuri efektive të programit të studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	nëpërmjet ndarjes së detyrave, përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës. Në Departamentin e Agrobiznesit bëhet shqyrtimi dhe miratimi i planeve mësimore, hartimi dhe rishikimi i programeve të lëndëve (silabuseve) bazuar në propozimet e nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin i teksteve mësimore në lëndët e programit të studimit; si dhe ndjekja e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit të Agrobiznesit. Kjo performancë përfshin korrektesën në respektimin e orarit të punës, cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të UK duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UK. <i>Ev.1.3. Plani Strategjik i Zhvillimit UK</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UK ka vendosur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me organizata të ndryshme për të përmirësuar cilësinë e programit të tij të studimit dhe për të ofruar mundësi të vlefshme për studentët dhe stafin akademik. Këto marrëveshje përfshijnë universitete dhe institucione kërkimore, organizata industriale dhe kompani private, si dhe organizata jo-qeveritare (OJQ)
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Bashkëpunimi me universitete si psh Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe institucione kërkimore ka për qëllim kryesor përmirësimin e kurrikulës dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore. Këto partneritete lejojnë shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve (psh Ciheam Montpellier), duke krijuar mundësi për projekte të përbashkëta kërkimore që pasurojnë përvojën akademike dhe profesionale të të dyja palëve.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga ana tjetër, bashkëpunimi me kompani private fokusohet në sigurimin e praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit për studentët. Përmes këtyre marrëveshjeve, studentët fitojnë eksperiencë praktike dhe njohuri specifike të sektorit të agrobiznesit, duke i përgatitur më mirë për tregun e punës. Nga ana tjetër, Organizatat jo-qeveritare (OJQ) luajnë një rol të rëndësishëm në angazhimin e studentëve në projekte sociale dhe mjedisore.

	Këto bashkëpunime ofrojnë mundësi për praktika në terren dhe përfshirje në projekte komunitare që kontribuojnë në zhvillimin profesional të studentëve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit social dhe mjedisor. Departamenti i Agrobiznesit në UK ka kryer një analizë të përfitimeve të arritura nga marrëveshjet e bashkëpunimit, por kjo analizë mbetet e përgjithshme dhe nuk arrin të evidentojë qartë tipologjinë e përfitimeve të veçanta që vijnë nga llojet e ndryshme të marrëveshjeve. Në këtë analizë, mungon një kategorizim i detajuar i përfitimeve specifike që lidhen me bashkëpunimet me universitete dhe institucione kërkimore, organizata industriale dhe kompani private, si dhe organizata jo-qeveritare (OJQ). Si rezultat, nuk është e qartë se cilat janë përfitimet konkrete për studentët dhe stafin akademik, dhe si këto përfitime kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale në rajon dhe më gjerë. GVJ vlerëson që Departamenti i Agrobiznesit duhet të hartojë në vijimësi një raport të detajuar që kategorizon përfitimet e marrëveshjeve në tre grupe kryesore: universitete dhe institucione kërkimore, organizata të agrobiznesit dhe kompani private, si dhe organizata jo-qeveritare (OJQ). Raporti duhet të përfshijë shembuj konkretë të bashkëpunimeve dhe të shpjegojë përfitimet specifike që kanë rezultuar nga secili lloj bashkëpunimi. Është e rëndësishme të theksohet ndikimi i drejtpërdrejtë në cilësinë e kurrikulës, zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve, dhe mundësitë praktike dhe të punësimit. <i>Ev.2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.10.2 Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.</i> <i>Ev.2.10.3 Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.</i> <i>Ev.2.10.4 Marrëveshje partneriteti (dualafs).</i> <i>Ev.3.5 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.</i> <i>Ev.3.6 raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit</i>			
Konkluzione	UK ka vendosur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete dhe institucione kërkimore, organizata të agrobiznesit dhe kompani private, si dhe organizata jo-qeveritare (OJQ). Këto marrëveshje kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së kurrikulës, zhvillimin e kërkimeve shkencore, dhe sigurimin e praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit për studentët. Megjithatë GVJ, rekomandon që raporti i analizës i realizuar nga njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të përfshijë shembuj konkretë të bashkëpunimeve dhe të shpjegojë përfitimet specifike që kanë rezultuar nga secili lloj bashkëpunimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër, ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UK si dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim. Skeda e programit të studimit është e paraqitur edhe në faqen web, në fakultetin dhe departamentin përkatës Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët janë me 4, 5, dhe 6 ECTS, praktika ka 16 ECTS dhe detyrimet përmbyllëse janë me 9 ECTS. Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në tabelat përmbledhëse të RVB, programi është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 35, përfshirë praktikën dhe diplomën apo detyrime të tjera përmbyllëse; - Në vitin e parë zhvillohen 13 lëndë, 6 lëndë në semestrin e parë dhe 7 lëndë në semestrin e dytë. - Në vitin e dytë zhvillohen 12 lëndë, 6 lëndë në semestrin e parë dhe 6 lëndë në semestrin e dytë. - Në vitin e tretë zhvillohen 10 lëndë, 8 lëndë në semestrin e parë dhe mbrojtja e praktikës dhe detyrimeve përmbyllëse në semestrin e dytë. - ngarkesa mësimore 4500 orë: 1971 orë në auditor; 2529 orë jashtë tij, 100 orë praktikë;

	- ngarkesa mësimore javore 20-25 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. GVJ, vëren që ka një mospërputhje sa i përket ngarkesës mësimore të raportuar në planin mësimor (- ngarkesa mësimore 4500 orë: 1571 orë në auditor; 2929 orë jashtë tij) dhe atij të paraqitur në tabelat përmbledhese të RVB dhe skedës në website-in e UK. <i>GVJ rekomandon që të unifikohet mënyra e paraqitjes së informacionit për të mos krijuar paqartësi për aktorët e interesuar</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv.</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i> <i>Ev.2.8.1 Model programi lëndor i programit të studimit “ekonomi bujqësore”.</i> <i>Ev. Tabelat përmbledhese per aneksin e RVB.</i> https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fbu&tipi=ba
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Lëndët që e përbëjnë programin e studimit mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me prodhimin bimor e shtazor, ekonomisë, biznesit, menaxhimit të tij, burimeve njerëzore, marketingut dhe aspekteve financiare. <i>Megjithatë programi nuk është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018, i ndryshuar, për sa i përket përmbajtjes sipas kategorive:</i> • Lëndë bazë (15%), • Lëndë karakterizuese (50%) • Lëndë plotësuese (8%) • Lëndë ndërdisiplinore (21%) dhe • Detyrime përmbyllëse (5%) Kështu në vitin e parë zhvillohen 13 lëndë në total, nga të cilat 5 lëndë janë të formimit të përgjithshëm, 3 lëndë karakterizuese për programin e studimit, 1 lëndë integruese dhe 3 lëndë plotësuese. Në vitin e dytë, zhvillohen 12 lëndë, nga të cilat, 9 lëndë karakterizuese, 1 lëndë integruese dhe 2 lëndë plotësuese. Ndërsa në vitin e tretë zhvillohen 10 lëndë, nga të cilat, 6 lëndë karakterizuese, 2 lëndë integruese, 1 lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv.</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i> <i>Ev.2.8.1 Model programi lëndor i programit të studimit “Ekonomi Bujqësore”.</i>

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Mbështetur në VKM 41/2018, e ndryshuar, dhe në Rregulloren e Programit të studimit, programi është organizuar si më poshtë: - Kategoria A - Lëndë Bazë-përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 27 ECTS ose 15%, në përputhje me <i>standardin (15-20%)</i>; - Kategoria B - Lëndë Karakterizuese-përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 90 ECTS ose 50%, në përputhje me <i>standardin (50-55%)</i>; - Kategoria C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese-nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 15 ECTS ose 8%, <i>standardi (12-15%)</i>; jo në përputhje me <i>Standartin</i> -Kategoria D - Lëndë plotësuese-gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 39 ECTS ose 21%, <i>standardi (10-15%)</i>; jo në përputhje me <i>Standartin</i> - Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 9 ECTS ose 5%, në përputhje me <i>standartin (3-5%)</i>. Si përmend dhe më lart, mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi BA në MA është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 35, përfshirë praktikën dhe diplomën; - ngarkesa mësimore 4500 orë: 1971 orë në auditor; 2529 orë jashtë tij, 100 orë praktikë; <i>IAL duhet të reflektojë të njëjtat të dhëna në skedën e programit dhe në rregullore)</i> <i>GVJ vlerëson që në raport me plotësimin e standarteve të VKM nr 41 shtojca nr 1 tabela nr 1 për komponentët mësimore, i kërkohet IAL-së të sistemojë numrin e krediteve duke respektuar standartin për kategorinë C dhe kategorinë D për programin e studimit Bsc në Menaxhim Agrobiznesi.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.8.1 Model programi lëndor i programit të studimit "Ekonomi Bujqësore".</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Me rëndësi specifike për programin e studimit është objektivi i forcimit të partneritetit me institucione të ndryshme publike dhe private në sektorë të ndryshëm të cilët do i ofronin studentëve mundësi për praktika mësimore dhe orientimi drejt mundësive të punësimit pas përfundimit të studimeve. Nga takimi i GVJ-së me stafin e angazhuar në këtë program studimi u theksua nevoja e agrobizneseve në zonën e Korçës për burime njerëzore në fushën e agrobiznesit si dhe sektorëve që lidhen ngushtë me të.

	Në vijim të analizës së programit të studimit dhe qasjes me standartin, praktika profesionale është paraqitur me 30 ECTS në programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion, diskutuam për mospërputhjet në numrin e krediteve si dhe mënyrën si organizohet praktika. Nga stafi u paraqit argumenti si vijon: <i>Bazuar në konkluzionet e disa projekteve studimore, por edhe duke konsideruar objektivat dhe rezultatet e projektit ndërkombëtar, "Dual AFS", ku njësia bazë (Departamenti i Agrobiznesit) është partner me disa universitete prestigjioze europiane, është konkluduar që ngarkesa e orëve të praktikës mësimore-profesionale të ketë një peshë specifike më të madhe (me 39 ECTS), si rezultat i rëndësisë që i jepet nga tregu i punës.</i> Ky argument paraqitet edhe në <i>Ev 2.5 Rregullorja e programit</i> të studimeve me argumentin e ndërkombëtarizimit dhe orientimit nga tregu i punës. Megjithatë GVJ, rekomandon që IAL duhet të bëjë përpjekje për të përshtatur programin e studimeve sipas VKM-së. Ndërkohë, në udhëzuesin për praktikat profesionale paraqitet workflow për njësinë bazë dhe atë kryesore si dhe aktorët e përfshirë në këtë proces. Po kështu paraqiten dhe detyrimet e studentëve në realizimin dhe mbrojtjen e praktikës profesionale. Në lidhje me Detyrimet Përmbyllëse, ato organizohen në formën e një provimi përfundimtar, për studentët me mesatare mbi 7, detyrimet përmbyllëse zhvillohen me një temë diplome. Detyrimet përmbyllëse përbëjnë 9 ECTS, pesha në kurrikul është 5%, standardi (3-5%) sipas VKM 41/2018, është i plotësuar. <i>Ev.2.22.1 Shkresë nr. 112 prot, datë 26.01.2022 "Për përcaktimin e fushave & temave të diplomës".</i> <i>Ev.2.22.2 Model teza provim formimi.</i> <i>Ev.2.22 Manual i hartimit të punimit të diplomës (bachelor) në 'Menaxhim Agrobiznesi'.</i> <i>Ev.3.20 Suplementi i diplomës së programit të studimit.</i> <i>Ev.3.21 Udhëzues për praktikat profesionale.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NA
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Agrobiznesi" i ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit në Fakultetin e Bujqësisë të UK, ka ngjashmëri me programet e Menaxhim Agrobiznesi të ofruara nga IAL shqiptare (Universiteti Bujqësor I Tiranës, https://ëëë.ubt.edu.al/fea). <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i>

	<i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.8.1 Model programi lëndor i programit të studimit "Ekonomi Bujqësore".</i> https://www.ubt.edu.al/fea			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Veprimtaria akademike e UK zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi në kodifikimin e programeve të studimit. IAL ka propozuar kodin si vijon për programin e studimit në shqyrtim, "Menaxhim Agrobiznesi" Kodi 63BA0413S <i>Ev.2.5.1: Shkrese nr.144 prot. date 26.01.2023 "Per kodifikimin e programeve te studimit"</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Bachelor në "Menaxhim Agrobiznesi" ofrohet vetëm nga UK, por vlen të theksohet se aktualisht Departamenti i Agrobiznesit, i cili është ofrues i këtij programi studimi, ka çelur një program të përbashkët studimi, Master Profesional në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" me Universitetin e Plovdiv Bullgari. <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i uniko 2020-2021.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit (bachelor) në "Menaxhim Agrobiznesi" 2022-2025.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon rishikimin e planit mesimor ne perputhje me standartin sa i takon kategorizimit te lëndëve sipas VKM 41/2018.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UK disponon akreditimin e fundit institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.02, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 26.01.2027. UK sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij katër fakultete emërtuar si vijon: - Fakulteti i Ekonomisë; - Fakulteti i Bujqësisë; - Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; - Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel	Fakulteti i Bujqësisë ka në përbërje të tij 3 departamente : 1. Departamenti i Agrobiznesit;

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

2. Departamenti i Agronomisë;
 3. Departamenti i Agroushqimit;
- dhe njësinë eksperimentale didaktike -EDE-në:

Fakulteti i Bujqësisë është njësi kryesore ku ofrohet programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” pranë Departamentit të Agrobiznesit. Ashtu si u përmend më lart, Departamenti i Agrobiznesit ofron edhe tre programe të tjera studimi, një diplomë profesionale në Menaxhim Biznesi Bujqësor, 120 ECTS dhe dy programe studimi, MP në “Drejtimit Agrobiznesi” dhe MP në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”. Të cilat janë të rëndësishme për të adresuar nevojat specifike të Rajonit të Korçës dhe të Shqipërisë në përgjithësi.

Në vijim GVJ paraqet një përshkrim të përmblendhur për të kuptuar integrimin vertikal dhe horizontal të kompetencave të ofruara nga njësi bazë.

1. Diplomë Profesionale në Menaxhim Biznesi Bujqësor:

- Ky program ofron njohuri praktike dhe teorike mbi menaxhimin e bizneseve bujqësore, duke përfshirë planifikimin, marketingun, dhe administrimin financiar.

- Kompetencat e fituara nga studentët synojnë të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të bizneseve bujqësore në Rajonin e Korçës,

2. Master Profesional në Drejtimit Agrobiznesi:

- Ky program avancoon njohuritë e studentëve në drejtimin strategjik të agrobizneseve.

3. Master në Menaxhim të Qëndrueshëm në Agroturizëm:

- Ky program kombinon menaxhimin e qëndrueshëm dhe turizmin rural, duke ofruar njohuri mbi zhvillimin e qëndrueshëm të destinacioneve turistike agroturistike.

- Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Rajonin e Korçës, i cili ka potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit dhe tërheqjen e turistëve të interesuar në përvoja autentike rurale.

Megjithatë, Duke pasur parasysh lidhjen logjike midis programeve të ciklit të parë dhe atyre të ciklit të dytë, GVJ vlerëson se programit në shqyrtim i mungojnë lëndë që paraqesin te studenti koncepte të qëndrueshmërisë dhe menaxhimit të burimeve natyrore. Për këto arsye, rekomandohet që programi i studimit BA në Menaxhim Agrobiznesi të përfshijë lëndët si më poshtë:

1. Ekonomia e Burimeve Natyrore:

- Kjo lëndë do të ofrojë njohuri mbi përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke ndihmuar studentët të kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së këtyre burimeve për brezat e ardhshëm.

2. Politikat Mjedisore:

- Kjo lëndë do të fokusojë në kuadrin ligjor dhe politik që rregullon mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Kjo është thelbësore për studentët që të kuptojnë ndikimin e politikave në praktikën e përditshme të agrobiznesit dhe agroturizmit në

një agjendë të përafrimit me BE dhe në një kontekst më të shprehur me ndryshime klimatike.

3. Inovacioni në Agrobiznes dhe Agroturizëm:

- Kjo lëndë do të prezantojë studentët me konceptet dhe teknologjitë e fundit në fushën e agrobiznesit dhe agroturizmit, duke i përgatitur ata për të aplikuar zgjidhje inovative në menaxhimin e qëndrueshëm të bizneseve të tyre.

Për të realizuar këto ndryshime pa ngarkuar tepër programin aktual, rekomandohet që këto lëndë të zëvendësojnë disa nga kreditet tashmë të alokuara për praktikën profesionale. Kjo do të sigurojë që studentët të kenë një kuptim të gjerë dhe të thellë të qëndrueshmërisë dhe menaxhimit të burimeve natyrore, duke i përgatitur ata më mirë për sfidat dhe mundësitë në sektorët e agrobiznesit dhe agroturizmit.

GVJ gjithashtu rekomandon që IAL të përditësojë faqen web, sepse në faqen e Departamentit nuk janë pasqyruar informacionet më të fundit në lidhje me programet e studimit të ofruara. Përditësimi i faqes web do të sigurojë që informacionet të jenë të qarta, të sakta dhe të aksesueshme për të gjithë studentët dhe palët e interesuara.

GVJ konstaton se Departamenti i Agrobiznesit, në vitin aktual 2023-2024, ka 11 personel akademik gjithsej, 7 pedagogë me kohë të plotë (PAE), 3 pedagogë me kohë të pjesshme (PAK), si dhe 1 personel ndihmës. Ndërkohe, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitin 2021- 2022 janë angazhuar 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 3 PAK. Nga të cilët, 3 pedagogë mbajnë titullin Profesor i Asociuar, 6 pedagogë mbajnë gradën Doktor Shkencash dhe 2 pedagogë janë Msc. Për vitin, 2022- 2023 në programin e studimit Menaxhim Agrobiznesi janë angazhuar 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 3 PAK. Nga të cilët, 3 pedagogë mbajnë titullin Profesor i Asociuar, 6 pedagogë mbajnë gradën Doktor Shkencash dhe 2 pedagogë janë Msc. Ndërsa, 2023- 2024/ 13 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 2 PAK.

Njësia bazë, Departamenti i Agrobiznesit përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/grada	2021 - 2022		2022 - 2023		2023 - 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-		-		-
Prof.As.Dr	2	-	2	-	2	-
Dr/PhD	5		5		5	
Msc		3		3		2
Në total	7	3	7	3	7	2

	Departamenti i Agrobiznesit është e organizuar në një grup mësimor. Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit të Biznesit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit mban gradën akademike “Doktor i Shkencave”. Për sa më sipër Njësia kryesore (FB) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për: - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik; - organizimin dhe strukturën akademike. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.pdf</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësive bazë “Departamenti i Agrobiznesit”.</i> <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit (bachelor) në “Menaxhim Agrobiznesi” 2022-2025.</i> <i>Ev.Tabelat permbljedhese per aneks RVB Ba Magb.</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e Programit ka të parashikuar koordinatorin e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Agrobiznesi” <i>Ev.1.1 Statuti i UK.pdf</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësive bazë “Departamenti i Agrobiznesit”.</i> <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit (bachelor) në “Menaxhim Agrobiznesi” 2022-2025.</i> <i>Ev.Tabelat permbljedhese per aneks RVB Ba Magb.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të pasuruar programin e studimit me lëndë të cilat konsiderojnë përveç burimeve njerëzore edhe burimet natyrore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit Bsc në “Menaxhim Agrobiznes”, njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. IAL disponon të gjitha informacionet mbi programin e studimit, përfshirë lëndët, përmbajtjen e tyre, zhvillimin e lëndëve, ndarjen në semestra, orët mësimore, pedagogët që japin lëndët, etj. Megjithatë, është e rëndësishme që këto informacione të reflektohen dhe përditësohen në faqen web të departamentit për të siguruar qasje të lehtë dhe të plotë për të gjithë studentët dhe palët e interesuara. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.Tabelat permbljedhese per aneks RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit është i strukturuar në 3 vite studimi, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër, ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UK si dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim. Skeda e programit të studimit është e paraqitur edhe në faqen web, në fakultetin dhe departamentin përkatës. Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët janë me 4, 5, dhe 6 ECTS, praktika ka 16 ECTS dhe detyrimet përmbyllëse janë me 9 ECTS. Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në tabelat permbljedhëse të RVB, programi është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 35, përfshirë praktikën dhe diplomën apo detyrime të tjera përmbyllëse; - Në vitin e parë zhvillohen 13 lëndë, 6 lëndë në semestrin e parë dhe 7 lëndë në semestrin e dytë. - Në vitin e dytë zhvillohen 12 lëndë, 6 lëndë në semestrin e parë dhe 6 lëndë në semestrin e dytë. - Në vitin e tretë zhvillohen 10 lëndë, 8 lëndë në semestrin e parë dhe mbrojtja e praktikës dhe detyrimeve përmbyllëse në semestrin e dytë.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	- ngarkesa mësimore 4500 orë: 1971 orë në auditor; 2529 orë jashtë tij, 100 orë praktikë; - ngarkesa mësimore javore 20-25 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.8.1 Model programi lëndor i programit të studimit "Ekonomi Bujqësore"</i> <i>Ev.Tabelat permbljedhese per aneks RVB Ba Magb.</i> <i>(https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fbu&tipi=ba)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit bazohen në kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për regjistrimet në universitete çdo vit akademik. Në Rregulloren e UK dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit (bachelor) në "Menaxhim Agrobiznesi" 2022-2025.</i> <i>Ev.Tabelat permbljedhese per aneks RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me drejtuesit, GVB, stafin akademik dhe Zyrën e Kurrikulave dhe Cilësisë, GVJ evidentoi që programi i studimit dhe silabuset përmbajnë të gjithë elementët në përputhje me VKM 41/2018, e ndryshuar, por formati i saj nuk përputhet me VKM 41/2018. GVJ rekomandon që krahas elementëve të detajuar në lidhje, me objektivat e lëndëve, temat, javët e zhvillimit si dhe formatet e kontrollit sa i takon komponentëve si orë leksion, seminare, brenda auditorit dhe jashtë tij nevojitet përditesimi edhe nga ana formale në përputhje me VKM 41/2018. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.Tabelat permbljedhese per aneks RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik	Gjatë vizitës në institucion, diskutuam që përtej ndryshimeve të vogla që programi pëson vit pas viti, nevojitet që Departamenti i Agrobiznesit, të bëjë një vlerësim nisur nga disa burime informacioni:

miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	- programeve të universiteteve përëndimore dhe ballkanike (jo të kryeqyteteve dhe qendrave metropolitane të mëdha); - nevojat e tregut të punës lokal dhe kombëtar; - tryezave të rrumbullakta me alumni, ekspertë dhe kolegë; - fokus grupeve me studentët.			
Konkluzione	GVJ vlerëson që programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë por IAL duhet të bëjë përpjekje për të përshtatur silabuset në përputhje me aktet nënligjore nga ana formale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Programi i studimit është i strukturuar për të mbuluar një gamë të gjerë të lëndëve, të cilat janë emërtuar në mënyrë që të reflektojnë qartë fokusin dhe përmbajtjen e tyre. Emërtimi i lëndëve është i tillë që tregon qartë objektivat e mësimin dhe fushat e specializimit që mbulojnë, duke ndihmuar studentët të kuptojnë rëndësinë dhe aplikimin e tyre praktike në sektorin e agrobiznesit. Programi përfshin një kombinim të leksioneve teorike dhe ushtrimeve praktike që sigurojnë një qasje të plotë ndaj tematikave të studiuara. Përmbajtja e veprimtarive është dizenuar për të zhvilluar aftësitë analitike, mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, të cilat janë thelbësore për suksesin në agrobiznes dhe për studime të mëtejshme akademike. Programi është ndarë në semestra dhe vitet akademike, duke përfshirë një shpërndarje të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, dhe plotësuese. Praktika profesionale është e integruara në program për të siguruar që studentët të kenë mundësinë të aplikojnë njohuritë teorike në mjedise reale pune. Më poshtë është një pasqyrë e shpërndarjes së lëndëve dhe praktikave sipas semestrave: Viti i Parë:

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

- Semestri I:

1. Analizë Matematike (5 kredite)
2. Teknikat e Prodhim Bimor (5 kredite)
3. Statistikë (5 kredite)
4. Mikroekonomi (6 kredite)
5. Informatikë (4 kredite)
6. Gjuhë e Huaj (5 kredite)

- Semestri II:

1. Komunikim Biznesi (4 kredite)
2. Prodhim Shtazor (4 kredite)
3. Ekonomi Bujqësore (4 kredite)
4. Siguria & Cilësia Ushqimore (4 kredite)
5. Bazat e Hortikulturës (5 kredite)
6. Makroekonomi (5 kredite)
7. Praktikë Mësimore Profesionale (4 kredite)

Viti i Dytë:

- Semestri III:

1. Statistikë Ekonomike (5 kredite)
2. Bazat e Marketingut (6 kredite)
3. E Drejta e Biznesit (4 kredite)
4. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (5 kredite)
5. Kontabilitet Financiar (6 kredite)
6. Praktikë Mësimore Profesionale (4 kredite)

- Semestri IV:

1. Administrim Publik (5 kredite)
2. Marketingu Agrar (5 kredite)
3. Menaxhimi i Zinxhirit të Vlerës (5 kredite)
4. Finance (5 kredite)
5. Menaxhim Karriere (4 kredite)
6. Praktikë Mësimore Profesionale (6 kredite)

Viti i Tretë:

- Semestri V:

1. Menaxhim i Biznesit të Vogël (4 kredite)
2. Politikat e Menaxhimit të Agrobiznesit (5 kredite)
3. Menaxhim Agrobiznesi (5 kredite)
4. Menaxhim Ferme (5 kredite)
5. Menaxhim Agroturizmi (5 kredite)
6. Drejtim Financiar (5 kredite)
7. Lëndë me Zgjedhje (3 kredite)
8. Lëndë me Zgjedhje (3 kredite)

- Semestri VI:

1. Praktikë Mësimore Profesionale (16 kredite)
2. Provim Formimi/Tëmë Diplome (9 kredite)



	Struktura e programit dhe përmbajtja e lëndëve sigurojnë që studentët të jenë të përgatitur mirë për studime të mëtejshme në nivel master apo specializime të tjera profesionale. Lëndët si Menaxhimi i Zinxhirit të Vlerës, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore etj., ofrojnë bazat e nevojshme për studime të avancuara në këto fusha. Lëndët praktike dhe projektet e përfshira në program ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të marrë role menaxheriale në sektorët e agrobiznesit dhe agroturizmit. Në përfundim, programi i studimit është i strukturuar në mënyrë që të përmbushë kriterin e thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve, duke siguruar një edukim të plotë dhe të balancuar që i përgatit ata për sfidat dhe mundësitë e tregut të punës. <i>Megjithatë si do përmendet shpesh në këtë raport nevojitet pasurimi i programit me lëndë që lidhen me menaxhimin e burimeve natyrore dhe lëndë që lidhen me inovacionin si një kërkesë e vazhdueshme e kohës.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Agrobiznesit janë në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultatet e të nxënit dhe vazhdimin e studimeve, si dhe kompetencat në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit është i strukturuar në mënyrë të tillë që të sigurojë një kombinim të balancuar të orëve teorike dhe praktike, duke përfshirë leksione, seminare dhe praktika profesionale. Struktura është e ndarë në semestra, ku secili semestër përmban një numër të caktuar të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Objektivat formuese të programit janë të orientuara drejt përgatitjes së studentëve për sfidat dhe mundësitë në fushën e agrobiznesit. Programi synon të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë e studentëve në menaxhimin e bizneseve bujqësore, duke i pajisur ata me mjete dhe teknika moderne të menaxhimit dhe planifikimit strategjik. Këto objektiva janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe kërkesat për profesionistë të kualifikuar në sektorin e agrobiznesit Programi i studimit është dizenuar në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, duke siguruar që niveli i kualifikimit të përputhet me standardet e përcaktuara për arsimin e lartë. Kjo përfshin zhvillimin e njohurive të thelluara dhe aftësive praktike që janë të

	nevojshme për sukses në tregun e punës dhe për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë. Rezultatet e të nxënit janë të orientuara drejt sigurimit të një baze teorike dhe praktike në fushën e agrobiznesit. Lëndët e përfshira në program synojnë të zhvillojnë aftësitë kritike të mendimit, aftësitë analitike, dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Studentët janë të inkurajuar të aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale përmes praktikave profesionale dhe projekteve. <i>GVJ, për të përmirësuar më tej programin e studimit dhe për të siguruar që ai të përmbushë plotësisht kërkesat e tregut të punës dhe standardet ndërkombëtare, rekomandon:</i> <i>1. Përfshirjen e Lëndëve mbi Qëndrueshmërinë dhe Menaxhimin e Burimeve Natyrore;</i> <i>2. Lëndë si Ekonomia e Burimeve Natyrore, Politikat Mjedisore dhe Inovacioni në Agrobiznes duhet të integrohen në program për të zhvilluar njohuritë e studentëve mbi praktikën e qëndrueshme dhe ruajtjen e burimeve natyrore.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi është i strukturuar për të ofruar 180 kredite në total, të shpërndara në mënyrë të balancuar midis lëndëve teorike dhe praktikave profesionale. Lëndët janë të vlerësuara me kredite dhe orë mësimore që reflektojnë përpjekjen dhe kohën e nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara të mësimin. Kjo strukturë siguron që studentët të kenë një përvojë të plotë dhe të balancuar të mësimin, duke zhvilluar njohuri dhe aftësi të thelluara në fushat përkatëse. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga vlerësimi i programit të studimit dhe vizitës në IAL, GVJ vlerëson që ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Programi i studimit është i strukturuar për të përfshirë një kombinim të veprimtarive teorike dhe praktike. Leksionet, seminarët, dhe praktikat profesionale janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të sigurojnë një zhvillim të integruar të njohurive dhe aftësive të studentëve. <i>Megjithatë, si u përmend dhe më sipër, ekziston problemi i mos përputhjes me standardet sa i përket futjes së praktikës dhe përfshirjes me 30 kredite. Aktualisht, praktikat profesionale nuk janë të alokuara me numrin e duhur të krediteve që kërkohet për të përmbushur standardet e caktuara. Për të adresuar këtë çështje, rekomandohet:</i>



	- <i>Rishikimi i Strukturës së Krediteve: Për të siguruar që praktikat profesionale të jetë në përputhje me standartin</i> <i>Ky rishikim dhe përshtatje do të sigurojnë që programi të jetë në përputhje të plotë me standardet dhe të përmbushë në mënyrë optimale nevojat e studentëve për formim praktik dhe teorik.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në lidhje me silabuset, sikurse e kemi përmendur edhe më lart, formati i silabusit nuk është përshtatur sipas VKM 41/2018, e ndryshuar. Në shumicën e lëndëve literatura nuk është e 5 viteve të fundit. <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga vlerësimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson që programi i studimit është i strukturuar për të përfshirë një kombinim të balancuar të formimit teorik dhe praktik. Kjo strukturë siguron përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, duke përgatitur studentët për tregun e punës dhe për studime të mëtejshme. Megjithatë siç është përsëritur shpesh në këtë raport, përfshirja e lëndëve mbi Ekonominë e Burimeve Natyrore, Politikat Mjedisore dhe Inovacionin në Agrobiznes do të plotësojnë boshllëqet ekzistuese dhe do të forcojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve. Këto masa do të sigurojnë që programi të përmbushë standardet dhe të përgatisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës. <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Struktura e programit dhe përmbajtja e lëndëve sigurojnë që studentët të jenë të përgatitur mirë për studime të mëtejshme në nivel master apo specializime të tjera profesionale. Përsa i përket punësimit, programi ofron njohuri dhe aftësi praktike që janë shumë të kërkuara në tregun e punës. Lëndët praktike dhe projektet e përfshira në program ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të marrë role udhëheqëse dhe menaxheriale në sektorët e agrobiznesit dhe agroturizmit. Në përfundim, programi i studimit është i strukturuar në mënyrë që të përmbushë kriterin e thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve, duke siguruar një edukim të plotë dhe të balancuar që i përgatit ata për sfidat dhe mundësitë e tregut të punës. Siç u paraqit me sipër rekomandohet përfshirja e lëndëve mbi Ekonominë e Burimeve Natyrore, Politikat Mjedisore dhe Inovacionin(<i>Management of Precision Agriculture</i>) në Agrobiznes (Sustainable agribusiness development) për të plotësuar boshllëqet ekzistuese dhe për të forcuar formimin teorik dhe praktik të studentëve. Këto masa do të

	<i>sigurojnë që programi të përmbushë standardet dhe të përgatisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës.</i> <i>Ev.2.7.1 Plani mësimor aktiv</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit në Menaxhim Agrobiznesi ofron një ekuilibër të mirë midis formimit teorik dhe praktik. Për të përmirësuar me tej, GVJ rekomandon rregullimin e krediteve për praktikën, përfshirjen e lëndëve mbi Ekonominë e Burimeve Natyrore, Politikat Mjedisore dhe Inovacionin, përshtatjen formale të silabusit dhe përditësimin e literaturës në pesë vitet e fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ vlerëson që tregu i punës sot është ndikuar thellësisht nga dinamikat lokale dhe globale, veçanërisht në fushat e Menaxhimit dhe Agrobiznesit, për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike, globalizimit, ndryshimeve klimatike dhe qëndrueshmërisë, si dhe ndryshimeve demografike. Universitetet lokale si UK duhet ta mbajnë parasysh këtë në strategjitë e tyre të zhvillimit për të përgatitur studentët për tregun e punës. Kjo përfshin përditësimin e kurrikulave me zhvillimet më të fundit, përfshirjen e lëndëve mbi teknologjitë e avancuara dhe qëndrueshmërinë, forcimin e bashkëpunimit me industrinë dhe përshtatjen me ndryshimet globale. Këto masa do të sigurojnë që studentët të jenë të përgatitur mirë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë lokale dhe globale. Nga kjo perspektivë, programi i studimit mund të jetë konkurrues në një mjedis dinamik nëpërmjet një fokusi më të theksuar të qëndrueshmërisë si dhe një bashkëpunimi më të ngushtë me komunitetin e biznesit lokal. Po kështu IAL duhet të inkurajojë kërkime shkencore në projekte inovative që adresojnë sfidat aktuale në agrobiznes si përdorimi i teknologjive të reja bujqësore, zgjidhjet për përballimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në	UK ka disa praktika të mira të bashkëpunimit me industrinë lokale në fushën e menaxhimit të agrobiznesit, të cilat duhet të monitorohen dhe të bëhen më të qëndrueshme, madje dhe në nivel departamenti, sa i përket prurjes së ideve që biznesi ka në rishikimin e vazhdueshëm të programit. GVJ vlerëson se programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Agrobiznesit vijnë të tërheqin studentë, por tkurja e numrit të tyre e

ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	bën të nevojshme analizën e avantazhit krahasues të një studenti që diplomohet në këtë program.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Pozitive janë raportet e pedagogëve me organizatat dhe bizneset lokale Bashkëpunimi ndodh, por në një pjesë të rasteve duhet formalizuar/analizuar. Panairi i Punës, konferencat studentore, praktikat mësimore dhe leksionet me të ftuar nga biznesi dhe institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete. Përfshirja e stafit të këtij programi studimi në shqyrtimi në projekte të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare është një vlerë e shtuar për programin e studimit, duke ofruar përvojë praktike dhe lidhje me biznesin bujqësor, si dhe përmirësuar vazhdimisht kapacitetet njerëzore në funksion të programit. Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Projekti DualAFS i financuar nga Erasmus+ e ka studentin pjesë qëndrore duke nxitur të mësuarin në punë. Drejtuesit e departamentit dhe pedagogët, gjatë takimeve periodike, diskutojnë me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Në nivel institucioni, bazuar në elementët e ofruar në kuadër të paketës së cilësisë, bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar dhe marrë vendime të mëtejshme. <i>Ev.2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Ev.2.9.1 Certifikata pjesëmarrjeje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare.</i> <i>Ev.2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.10.2 Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.</i> <i>Ev.2.10.3 Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.</i> <i>Ev.2.10.4 Marrëveshje partneriteti (dualafs).</i> <i>Ev.2.11 Vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit.</i> <i>Ev.2.12 Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (rishikimi i kurrikulës).</i> <i>Ev.2.13 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FB për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> <i>Ev.3.10 Praktika e organizimit të tryezave të përbashkëta me operatorët e sektorit privat.</i> <i>Ev.3.12 Studim tregu për programin e studimit "Menaxhim Agrobiznes".</i> <i>Ev.3.12.1 Strategjia e studimit të tregut.</i> <i>Ev.3.13 Pyetësori i NjSBCS pas sezonit në bashkëpunim me keshillin studentor.</i> <i>Ev.3.14 Të dhëna nga pyetësoret me studentet.</i>

Konkluzione	UK dhe me konkretisht Departamenti I Agrobiznesit, pergjegjes per programin e studimit ne ciklin e pare ne Menaxhim Agrobiznes nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, duke pasur marrëveshje bashkëpunimi me një tipologji diverse organizatash, si dhe pjesëmarrje të konsiderueshme në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, për hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me cilesi të objektivave të tyre. Pjesëmarrja ne projekte Erasmus+ qe nxisin keto lloje bashkepunimesh perbejne nje element pozitiv.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, për programin e studimit në shqyrtim, vërehet se UK ka përfshirë të gjitha format e mësimdhënies e mësimnxënies siç janë janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/kuize, praktikat profesionale, orët e hapura, të paraqitura në planin mësimor dhe në syllabusët përkatëse. Këto elementë janë të dokumentuar dhe paraqitur pranë ASCAL. Përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, pra në auditor, IAL ka ndërmarrë edhe formën online të mësimdhënies, në përgjigje të situatës pandemike të krijuar nga Covid19. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL si dhe nga takimet në institucion, vërehet se janë parashikuar dhe ndërmarrë edhe orët e hapura. Përveç aftësimin teorik UK ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me aktorë jashtë IAL për aftësim praktik në institucione rajonale që kanë bujqësinë dhe ushqimin në fokus të tyre. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore te studimit.</i> <i>Ev.2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i> <i>Ev.3.10 Praktika e organizimit te tryezave te perbashketa me operatorët e sektorit privat.</i> <i>Ev.3.16 Model mesimi on-line.pdf.</i> <i>Ev.3.18 Shembull i oreve te hapura.pdf.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Siç është përmendur dhe më lart, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, pra në auditor, UK dhe më konkretisht njësia bazë Departamenti i Agrobiznesit ka ndërmarrë edhe formën online të mësimdhënies, në përgjigje të situatës pandemike të krijuar nga Covid19. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL si dhe nga takimet në institucion, vërehet se janë parashikuar dhe ndërmarrë edhe orët e hapura siç është reflektuar. Përveç aftësimit teorik IAL ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me aktorë jashtë institucionit për aftësim praktik që është e rëndësishme për vetë karakteristikën e programit të studimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit konsistojnë kryesisht me institucione të ndryshme rajonale që operojnë në fushën e bujqësisë siç janë <i>Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Korçë, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)</i> etj., të cilat mundësojnë studentët të njihen nga ana praktike si realizohet kërkimi i aplikuar, si transferohet njohuria tek fermerët etj. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore të studimit.</i> <i>Ev.2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i> <i>Ev.3.16 Model mesimi on-line.pdf.</i> <i>Ev.3.18 Shembull i oreve të hapura.pdf.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL dhe nga diskutimet me stafin akademik vërehet se stafi akademik inkurajohet dhe mbështetet të zhvillohet dhe përmirësojë cilësinë e mësimdhënies duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme dhe projekte ndërkombëtare që do çonjnë në përmirësimin e kurrikulës dhe teknikave të mësimdhënies. Një shembull konkret që u përmend në takimet me stafin e programit dhe atë të zyrës së projekteve është pjesëmarrja e disa nga pjesëtarët e stafit në projektin DUAL/AFS, SMART-AL etj. Stafi nxitet të marrë pjesë në mobilitete mësimdhënieje në institucione ndërkombëtare në bazë të marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit. Bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që UN dhe FB ka me IAL dhe institucione të tjera kërkimore, në tre vitet e fundit, stafi akademik dhe studentët e Departamentit të Agrobiznesit janë angazhuar në shkëmbime stafi dhe studentësh në disa IAL dhe institucione kërkimore si: • Hartimi i modulit “<i>Instruments and Policy Evaluation Methods</i>” në bashkëpunim me staf akademik dhe ekspertë të Universitetit Hohenheim, Gjermani • Hartimi i modulit “<i>Territory Innovation and Actions</i>” në bashkëpunim me stafin akademik dhe Institutin kërkimor-shkencor CIHEAM, Montpellier, Francë • Hartim i modulit “<i>Supply Chain Management</i>” në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit “Nuertingen-Geislingen”, Gjermani;

	• Mësimdhënie pranë universitetit “Nuertingen-Geislingen” në programin e studimit Master Shkencor; • Udhëheqje e përbashkët e tre studentëve nga Instituti kërkimor “CIHEAM”, pjesë e programit MIDAS • Mësimdhënie në programin e ciklit të tretë të studimit (Master Ekzekutiv) pranë UBT • Zhvillimi i mësimit semestral (7 studentë - 3 muaj), për programin e studimit “Menaxhim Agrobiznesi” në Universitetin Savonia, Finlandë • Zhvillimi i mësimit semestral (1 student - 3 muaj), për programin e studimit • “Menaxhim Agrobiznesi” në Universitetin Nuertingen-Geislingen, Gjermani. Këto aktivite, kanë ndikuar në rritjen profesionale të stafit akademik, duke dhënë një impakt pozitiv në implementimin e standardeve evropiane të mësimdhënies dhe sidomos nxitjen e të nxëniet gjatë të vazhduar, për përshtatjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e kurrikulave në varësi të nevojave të tregut të punës. <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Ev.2.9.1 Certifikata pjesëmarrjeje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.10.2 Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.</i> <i>Ev.2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani.</i> <i>Ev.2.20 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik & Institutit kërkimor-shkencor CIHEAM.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre. Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita e kryer në IAL, vërehet se UK ka hartuar udhëzues të posaçëm dhe ka zhvilluar mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, duke patur parasysh edhe situatën pandemike nëpërmjet formularëve të vlerësimit. Në këtë proces janë të përfshirë pedagogët edhe studentët. Hartimi i udhëzuesve dhe ngritja e strukturave përkatëse është rregulluar nëpërmjet Statutit të institucionit, Rregullores së institucionit, Rregullores së Senatit Akademik, Udhëzimit për miratimin e teksteve mësimore në nivel të Njesisë Bazë, si dhe Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, reflektuar në Nenin 3, pika 2 për ngritjen e strukturës përkatëse si dhe në Nenin 6, pika 8, për monitorimin e cilësisë. Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies pasqyrohet në raportet e vlerësimit të kryer nga NJSBC-ja. Gjithashtu, monitorimi i cilësisë është rregulluar nëpërmjet Manualit të Cilësisë i cili përcakton hapat, detyrat dhe strukturat për garantimin e cilësisë në mësimdhënie. Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet



studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	pyetësorëve. Përfshirja e studentëve në monitorim kryhet edhe nëpërmjet përfaqësimit të një studenti në NJSBC. Publikimi i të dhënave të monitorimit së cilësisë dhe aspekteve të tjera në raport me studentët dhe jo vetëm është rregulluar nëpërmjet Manualit të sistemit elektronik Pitagora. Gjithashtu, sipas stafit të UK që morën pjesë në takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion të dhënat e nxjerra nga aktivitetet monitoruese për cilësinë por jo vetëm publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Sidoqoftë, gjatë takimeve dhe nga konstatimet u vërejt se faqja zyrtare e institucionit nuk përditësohet. Për shembull programet e studimit të Departamentit të Agrobiznesit nuk janë përditësuar. Aktualisht në funksionalitet të plotë është faqja e Facebook e institucionit dhe departamentit përgjegjës për programin në proces akreditimi. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.1.5 Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC, QKA).pdf.</i> <i>Ev.1.6 Marreveshje RASH per sistemin elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.1.11 Rregullore e Senatit Akademik.pdf.</i> <i>Ev.1.12 Udhëzim për miratimin e teksteve mësimore në nivel njësie bazë.pdf.</i> <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i> <i>Ev.2.9 Jeshkrimet e stafit te perfshire ne programin e studimit.</i> <i>Ev.2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani.</i> <i>Ev.3.7 Raportet vjetore te NJSBC.pdf.</i> <i>Ev.3.13 Pyetësi studentor.pdf.</i> <i>Ev.3.14 Pyetësi i stafit akademik.pdf.</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson që kuadri institucional, bashkëpunimet e lindura nga projektet ndërkombëtare, pjesëmarrja aktive e stafit në mobilitete si dhe eksperiencia e konsiderueshme e stafit të angazhuar në këtë program studimi bën të mundur që IAL të garantojë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin,			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e	GVJ vlerëson që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet formave të ndryshme të përcaktuara në rregulloren e institucionit. Në rregulloren e institucionit përcaktohen procedurat që ndiqen për realizimin e vlerësimit

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43433

Web site: www.ascal.al

programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	të studentëve ku parashikohen dhe format e ndryshme të vlerësimit si dhe organizimi i tyre. Në nenin 103, përcaktohet gjithashtu mundësia dhe procedura e studentit për ankimin e vlerësimit. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, rregullorja e njësive bazë parashikon shpalljen e komisioneve të provimit një javë përpara provimit. Rolin kryesor në përgatitjen e formave dhe procesit të vlerësimit e ka titullari i lëndës. Përgjithësisht vlerësimet e dijeve dhe njohurive të studentëve janë të vlerësuara nga titullari përgjegjës i lëndës, dhe në rastin e provimit me gojë mund të bëhet nga titullari apo grup pedagogësh. Referuar takimeve me stafin akademik dhe studentët, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL, studentët informohen për mënyrën dhe format e vlerësimit në fillim të çdo lënde/moduli, nga titullari i lëndës, nga syllabuset e lëndëve, si dhe në orët e para të mësimt. Studentët marrin informacion mbi metodologjinë e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Gjithashtu studentët informohen mbi planin mësimor të programit të studimit, ku përcaktohet ndarja në lëndë/module, si dhe përmban emërtimin e plotë, kodin, vitin/semestrin kur zhvillohet, orët në auditor (leksione/seminare/laboratorë) etj. Nga vizita në institucion u vërejt se plani mësimor ishte afishuar në hollin e Fakultetit të Bujqësisë (kati i II-të). Sipas bisedave u mësua se përdoret gjithashtu edhe korrigjimi elektronik nëpërmjet projektit Cleanscore. Për matjen e klësive së mësimdhënies përdoren forma të ndryshme të vlerësimit të performancës dhe pse kjo e fundit është aplikuar për studentët e programit të studimit Diplomë profesionale në “Menaxhim Biznesi Bujqësor” tregon që IAL e ka një praktikë të vlerësimit të performancës së pedagogut nga këndvështrimi i studentit. Institucioni ka një sistem digjital të brendshëm të menaxhimit “Pitagora”. Ky sistem elektronik informon studentët online për pikët dhe notat në kohë reale. Stafi akademik deri në fund të muajit Dhjetor, duhet të publikojë online syllabuset e lëndëve, në programet e studimit në të cilat ai jep mësim. Kontrollon grafikun e provimeve dhe hedh rezultatet e frekuentimit dhe të vlerësimit të vazhduar për secilin student. Gjeneron rezultatet e provimit brenda afateve të përcaktuara në Manual. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësive bazë “Departamenti i Agrobiznesit”.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.3.13 Pyetësi i NjSBCS pas sezonit në bashkëpunim me keshillin studentor.</i> <i>Ev.3.17 Model analiza në përfundim të një moduli.pdf.</i>
---	---

Konkluzione	<i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërshtuar punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare. Zbatimi i këtyre procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantojnë si nga stafi akademik ashtu edhe ai ndihmës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e Departamentit të Agrobiznesit përcakton parimet e kriterëve të vlerësimit për lëndën, si edhe tabelën e vlerësimit të notave brenda kornizave kohore të dedikuara sipas karakteristikave të lëndës. Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, testi i njohurive bëhet gjatë të gjithë lëndës duke u bazuar mbi elementë të ndryshëm siç janë pjesmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve. Kjo shihet edhe në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra, çfarë përcaktohet qartë në rregullore duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës, dhe konkretisht: a) detyra specifike sipas llojit të lëndës; b) provimi përfundimtar apo detyra kursi; c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi krijon mundësinë për të vlerësuar progresin e arritur nga studentët dhe i mundëson atyre të evidentojnë mangësitë e paraqitura. <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet zhvillohen si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik, pasi institucioni ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit të cilat sigurojnë aksesin e studentëve në informacionin e nevojshëm siç janë notat, frekuentimi etj., por edhe sigurojnë transparencën e vlerësimit dhe shmangin format e mundshme të abuzimit. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.1.20 Rregullore e Bordit të Amdinistrimit.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e silabuseve përkatës për çdo lëndë, dhe rregulloren e IAL dhe zhvillohet duke marrë parasysh vlerësimet e pjesshme dhe ato përfundimtare të

	secilit element të testimit të lëndës siç u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për çdo element vendosen në një rubrikë të veçantë të silabusit, si edhe u shpjegohet studenteve në fillim të çdo lënde. Komisionet e provimeve të përbërë nga dy pedagogë dhe titullari i lëndës, ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit në përputhje me Statutin e Universitetit, rregulloren e provimeve dhe udhëzimin përkatës të Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët ofrojnë sugjerime dhe feedback për secilin nga elementët e vlerësimit të studentit. Vlerësimit të studentit i bashkangjitet një feedback nga ana e pedagogut dhe përcillet përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin. Studentët marrin feedback gjatë gjithë vitit lidhur me përparimin e tyre përse i takon përputhshmërisë së performancës së tyre akademike me kërkesat e lëndës <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UK përcakton në "Kodin e Etikës" dispozitat për shkeljet disiplinore, siç mund të jetë kopja, rastet e plagjiaturës apo format e tjera të mashtrimit, rastet e të cilave trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Ekziston sistemi kundër plagjiaturës, të cilit i nënshtrohen të gjithë punimet e studentëve. Plagjiatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët gjatë zhvillimit të lëndës, në mënyrë që studentët të informohen si duhet se çfarë përbën plagjiaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore. Sikundër u theksua më lart rregulloret në nivel IAL dhe në nivel programi përcaktojnë masat që marrin pedagogët në mënyrë që procedura e provimit të jetë e pakorruptueshme dhe si të zbatojnë rregulloren e universitetit për të gjithë ata studentë që shkelin etikën akademike. Së bashku me specialistin IT krijohet dritarja përkatëse ku studentët mund të dorëzojnë detyrat e përfunduara. Elementë të etikës përmenden edhe në silabuset e secilës prej lëndëve që përbëjnë programin e studimit. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.1.19 Kodi i Etikës së UK.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.22 Manual për Hartimin e Temës së Diplomës.</i>

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës me një sistem prej 10 notash, ndërsa nota më e ulët kaluese është 5. Këto forma përfshijnë aftësitë analitike të studentëve, ato prezantuese, kapacitetet për të sintetizuar materialin që i vihet në dispozicion dhe promovuar një këndvështrim kritik. Rregullorja e UK përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore, jo më shumë se 8 ditë nga data e provimit përfundimtar - pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik. Në provimet me gojë nota ofrohet direkt pas përfundimit të provimit. Ky informacion është i pasqyruar në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e internetit të universitetit. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsyetim lidhur me vlerësimin me notë. Studentët kanë të drejtën e ankimit për notën brenda 5 ditëve nga marrja e përgjigjes së provimit pranë pedagogut të lëndës, i cili shqyrton nëse ka patur ndonjë gabim në korrigjimin e provimit, dhe në rast se studenti nuk bindet për argumentimin ka të drejtë të ankohet pranë dekanatit që ngre një komision të posaçëm vlerësimi. Studentët ndjekin një procedurë të veçantë për ankimimet në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat duke përfshirë si anën akademike ashtu edhe atë logjistike apo administrative. Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe nëse pedagogu nuk e gjykon me vend të rishikojë notën, atëherë studenti i drejtohet koordinatorit të Departamentit, për të përfunduar më pas me komisionin vlerësues që ngrihet në përputhje me procedurat për këtë ankimim, të cilat janë të sanksionuara në Rregulloren e Provimeve. Procedurat janë transparente dhe mund të ndiqen në çdo hap si nga studenti ashtu edhe nga sekretaria, e cila dokumenton dhe arkivon çdo hap duke përfshirë edhe raportin përfundimtar të aprovuar nga dekanati. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i>
Konkluzione	<i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nepermjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacioni u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit i ofron studentëve njohuri si të zhvillojnë aftësitë kritike në disiplinat e ndryshme brenda programit të studimit. Profili akademik i pedagogëve, bashkëpunimi i tyre në nivel akademik me homologët në aktivitete shkencore ku marrin pjesë edhe studentët krijojnë mundësinë që këto njohuri të mund të pasqyrohen edhe në lëndët përkatëse duke harmonizuar lëndët integruese/ndërdisciplinore me praktikën profesionale (institucionale) dhe mikrotezën në programin didaktik që vihet në dispozicion të studentëve. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Nga vizita në institucion me stafin akademik dhe studentë, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar pranë ASCAL u konstatua se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve. Në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet kuizeve, rasteve studimore, ditëve të hapura, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve. Po kështu, duke u nisur nga shifrat për rolin e sektorit bujqësor në rajonin e Korçës dhe për potencialin e punësimit të të rinjve në këtë sektor, GVJ vlerëson që programi i studimit në shqyrtim është një nevojë e kohës. Por siç është përsëritur edhe me lart duhet të reflektojë përmirësime të vazhdueshme që lidhen me një kontekst të: ▪ Perspektivës së anëtarësimit në BE ▪ Transformimit të politikave publike ▪ Europianizimit të politikave bujqësore ▪ Adoptimit i formave agroekologjike të prodhimit, transformimit dhe tregtimit etj. Programi i studimit parashikon një harmonizim të njohurive specifike të fushës me ato të mendimit kritik, aspekteve humane, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke përfshirë këtu edhe gjuhën e huaj. Transmetimi i njohurive tek studentët kryhet duke përfshirë si njohurive metodologjike ashtu edhe punën konkrete nëpërmjet projekteve individuale ose në grup – për të mbështetur zhvillimin e soft-skills - apo detyrave të kursit për të nxitur zhvillimin e mendimit kritik të studentëve
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.	
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	dhe zbatimit në praktikë të këtyre njohurive. Po kështu, studentët mbështeten tek teknologjia e informacionit (e-library apo format e ndryshme të prezantimit).
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Për të analizuar kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, GVJ vëren se institucioni ka rregullore dhe mekanizma vlerësimi të cilat nxjerrin në pah problematikat e ndryshme si dhe për të orientuar studentët për zbatimin e tyre. Në të njëjtën kohë, edhe rregulloret e institucionit dhe programit parashikojnë këto aspekte të vlerësimit të studentëve. Njësia bazë dhe stafi akademik analizon në mënyrë periodike ecurinë e punës dhe rregullon procesin e vlerësimit për provimet finale të moduleve. Në analizën periodike kërkohet nga pedagogu i çdo lënde pasqyrim i objektivave të arritura dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentë gjatë vizitës në institucion u shpreh se stafi akademik/pedagogu pas përfundimit të çdo lënde realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara dhe e orienton studentin drejt provimit përfundimtar. Mësimdhënia zhvillohet duke u bazuar në kompetencat që synon të arrijë programi duke u bazuar në dy metodologji kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë, literatura e rekomanduar. Kjo realizohet falë infrastrukturës në aspektin teorik sic është libraria online, biblioteka apo edhe akses i qull studentët në programe të ndryshme të literaturës. Për sa i përket praktikës laboratorike, nga vizita në institucion në mjediset laboratorike u vërejt se institucioni ka hapësira dhe pajisje funksionale për realizimin e orëve laboratorike, për modulet specifike që parashiokojnë orë laboratorike. Gjithashtu GVJ vëren se institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi për formësimin praktik të studentëve me institucione si QTTB (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore) Korçë, AREB (Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor) Korçë, të cilat janë institucionet e duhura dhe të përshtatshme për kryerjen e praktikave mësimore në terren, të cilat merren direkt me fermerët në aspektin zbatues. Personeli akademik është i organizuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit dhe për këtë qëllim organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminarët akademike të organizuara nga UN apo IAL të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagoget. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësive bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i>

	<i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lendore te studimit.</i> <i>Ev.2.9 Jeteshkrimet e stafit te perfshire ne programin e studimit.</i> <i>Ev.2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkepunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani.</i> <i>Ev.3.18 Shembull i oreve te hapura.pdf.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, por edhe falë mobilitetit të pedagogëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë një grup pyetjesh (fond pyetjesh) për çdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike që studentët kanë për përmbylljen e programit. Tema dhe udhëheqësit miratohen nga Departamenti i Agrobiznesit pas konsultimeve me studentët. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.6 Modeli i diplomës së programit të studimit.pdf.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit, parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë një grup pyetjesh (fond pyetjesh) për çdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

	<i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët mund të zgjedhin ndërmjet stafit akademik të programit udhëheqësin për dizertacionin duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën e diplomes që ata mendojnë. Më pas së bashku me udhëheqësin kristalizohet më tej. Përcaktimi i udhëheqësit dhe temës së dizertacionit i hap rrugën aprovimit nga ana e koordinatorit të Departamentit. Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshtimi i metodologjisë së dizertacionit me kerkimin shkencor, rezultatet, përpunimin e tyre dhe hartimin e konkluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi, i cili duhet të japë aprovimin në mënyrë që studentit të mund të dorëzojë diplomën. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda institucionit për hartimin e dizertacionit, por edhe jashtë tij. Për këtë, udhëheqësi ofron gjithashtu nëpërmjet kontakteve personale edhe mundësinë që studentit të marrë ekspertizën dhe ndihmën e nevojshme me ekspertë jashtë institucionit kur kjo është e nevojshme. Nga takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit në shqyrtim, në departament kishte studentë incoming për një semestër nga Turqia, Greqia, Franca etj. Studentët e institucioneve arsimore si CIHEAM, BOKU, CEEPUS kanë zhvilluar disertacionin në bashkëudhëheqje me pedagogët e departamentit të Agrobiznesit. Po kështu studentët incoming kanë zhvilluar periudhën e stazhit duke u drejtuar nga pedagogë të angazhuar në programin e studimit. Nga ana tjetër, 7 studentë të programit të studimit në shqyrtim kanë zhvilluar mobilitete pranë Universitetit të Savonia në Finlandë, internshipe në Greqi, pranë Ciheam në Montpellier, Francë. GVJ vlerëson që programi i studimit ka ndërkombëtarizimin një nga pikat e tij më të forta. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. Takimi me stafin e projekteve në IAL.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Tema e diplomës dhe provimi vlerësohen nga komisioni prej jo më pak se dy anëtarësh i ngritur dhe aprovuar për këtë qëllim sipas rregullores së departamentit/programit të studimit/ rregullores së UK me një sistem notash nga 4-10 – dhe bërë kalimin nga sistemi i pikëve teka ai i notave.

	Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i notës 5. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	IAL në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomën "Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi". Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e ciklit të parë të studimeve dhe me suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga MAS dhe Qendra e Shërbimit të Studentëve (QSHA), dhe regjistrohen pranë Zyrës së Regjistrimit, ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të veçantë. <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev.3.20 Suplementi i diplomës së programit të studimit.pdf.</i> <i>Ev.3.23 Vërtetim i QSHA nr. 851104 prot; datë 15.03.2022 "Për regjistrimin në regjistrin shtetëror të diplomave".pdf.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Kjo sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluar dhe aktiviteti akademik. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi. <i>Ev.1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK.</i>			
Konkluzione	IAL ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga udhëheqësi i tezës së diplomës. IAL e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën ashtu edhe suplementin e diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në Departamentin e për periudhën 2021-2024 është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2021-2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE (3 Prof.As. 5 Dr. 1 Doc. 2 Msc.) dhe 3 PAK (3 Msc.). 2. Për vitin akademik 2022-2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 11 PAE (3 Prof.As. 6 Dr. 2 Msc.) dhe 3 PAK (3 Msc.). 3. Për vitin akademik 2023-2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 11 PAE (2 Prof.As. 7 Dr. 2 Msc.) dhe 2 PAK (2 Msc.). Aktualisht numri i stafit akademik efektiv pjesë e Departamentit të Agrobiznesit është 7 (shtatë) ku 2 prej të cilëve mbajnë gradën Prof. As; 5 prej tyre janë me gradën Dr. <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.9 Jeteshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Ev.3.29 Procedura e rekrutimit të personelit akademik.pdf.</i> <i>Ev.Tabelat përmbledhese për aneks RVB Ba Magb.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit është realizuar në përputhje me kërkesat dhe kuadrit rregullator në fuqi sa i takon raportit të PAE dhe PAK. Aktualisht, personeli akademik efektiv mbulon afërsisht 90% të ngarkesës mësimore, kjo për faktin se niveli i orëve që mbulohet nga pedagogët efektivë të Departamentit të Agrobiznesit është i lartë. Nga ana tjetër u konstatua se disa pedagoge PAE realizojnë nga 7, 8 deri në 9 lëndë të cilat në disa raste shkojnë në 400-450. Kjo situatë sidomos e shpërndarjes së lëndëve bie ndesh me Udhëzimin Nr. 29, datë 10. 09. 2018 "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Ku thuhet se: Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbaje në një vit akademik më shumë se 3 lëndë

	<i>semestrare në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestra, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrare, ose 3 lëndë vjetore. Ndërkohë që kjo shpërndarje dhe ky përqëndrim i lartë i lëndëve në një pedagog në disa raste nuk është as në përputhje me backgroundin e stafit PAE si dhe tipologjisë së lëndëve që jep.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Ev. Tabelat përmbledhese për aneks RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi. Punësimi i stafit PAE është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. <i>Ev.3.25 Kontratë pune (staf akademik i angazhuar me kohë të pjesshme pranë UBT).pdf.</i> <i>Ev.3.29.3 Kontratë pune (staf akademik i angazhuar me kohë të pjesshme).pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në RVB por edhe në dokumentacionin bashkangjitur paraqiten qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim në UK, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurrim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. <i>Ev.2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Ev.3.29 Procedura e rekrutimit të personelit akademik.pdf.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstatoi që Fakulteti i Bujqësisë respektivisht Departamenti i Agrobiznesit ka një 1 (një) punonjës të angazhuar si personel ndihmës akademik (i kategorizuar si laborant/sekretar) i angazhuar në punët administrative. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori bën pjesë specialisti Laborant/Sekretar që është i angazhuar për programet e studimit që ofron Departamenti i Agrobiznesit. <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev.3.29 Procedura e rekrutimit të personelit akademik.pdf.</i>

	<i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion që UK, me përgjegjës Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin e studimit. Pas verifikimit në mënyrë rastësore të dosjeve të personelit akademik, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Përgjegjësi i Departamentit, mbledh, përditëson dhe arkivon çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit. Gjithashtu zyra e burimeve njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të UK, arkivon të dhëna të përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit. Përditësimi i dokumentacionit bëhet nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit. <i>Ev.1.4 Rregullorja e drejtorise juridike dhe burimeve njerezore.pdf.</i> <i>Ev.2.9 Jeteshkrimet e stafit te perfshire ne programin e studimit.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ konstatoi që UK në nivel institucioni por edhe Fakulteti Bujqësisë dhe vetë Departamenti i Agrobiznesit kanë 24 marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit të studimit praktika profesionale. Praktika profesionale realizohet mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara nga UK me institucione dhe biznese të Korçës dhe rajonit. GVJ konfirmoi këtë proces dhe nga takimi me studentët e programit gjithashtu edhe me stafin. Drejtuesi i njësive kryesore ka transformuar në praktikë lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë pritëse deri një muaj para fillimit të praktikës. Praktikatat profesionale zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. <i>Ev.2.3 Rregullore e njësive bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev.2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.pdf.</i> <i>Ev.3.21 Udhëzues për praktikat profesionale.pdf.</i> <i>Ev. Tabelat permbledhese per aneks RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë	Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i departamentit angazhohet në mbikëqyrjen në ambientin pritës si edhe në realizimin e praktikave profesionale të studentëve sipas marrëveshjeve të bëra me UK apo FB që të përmbushin detyrimin e kryerjes së praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës profesionale, personeli mbikqyrës në ambientin ku realizohet praktika profesionale, përpilon një relacion përfundimtar vlerësimi mbi ecurinë dhe arritjet e studentit për kryerjen e praktikës profesionale. E tërë

në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	procedure regullohet nga Rregullorja e Njesisë Bazë së Departamentit të Agrobiznesit, Neni 22. <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet në përmbushje kryesisht të këtij standardi bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në RVB. Departamenti i Agrobiznesit ka të angazhuar personel akademik dhe ndihmës për realizimin e programit. GVJ rekomandon që institucioni të marrë masa për shpërndarjen e lëndëve në plotësim të standardit të kërkuar. Sipas evidencave rezultojnë pedagogë me 8 dhe 9 lëndë të realizuara me një total rreth 450 orësh. Korniza ligjore në fuqi, dikton numër shumë më të kufizuar lëndësh për pedagog PAE, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të ofruara nga ky staf akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Departamenti i Agrobiznesit e zhvillon procesin mësimor në godinën e Fakultetit të Bujqësisë të UK. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin e studimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përkatësisht, në dispozicion janë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FB</th><th>Nr. Sallash</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni + seminari</td><td>16</td></tr> <tr> <td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td><td>18</td></tr> <tr> <td>Bibliotekë</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Zyra Informacioni per Studentë</td><td>1</td></tr> </tbody> </table> <i>Ev.4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FB.pdf.</i> <i>Ev.Tabelat permbledhese per aneks RVB Ba Magh.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>	Mjedisi - FB	Nr. Sallash	Salla leksioni + seminari	16	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	1	Zyra për stafin	18	Bibliotekë	1	Zyra Informacioni per Studentë	1
Mjedisi - FB	Nr. Sallash												
Salla leksioni + seminari	16												
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	1												
Zyra për stafin	18												
Bibliotekë	1												
Zyra Informacioni per Studentë	1												
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	GVJ konstatoi gjatë vizitës që sallat që përdorën gjatë procesit mësimor janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik.												

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë disa prej tyre dhe me pc-kompjuter, tabela bashkëkohore, kompjuterë dh e vende pune me internet. Godina e DA është e pajisur me linjë interneti dhe intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët, krahas rrjetit të internetit (kabllor/lan) funksionon edhe sistemi ëireless i internetit, duke iu mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambientet e jashtme. Sallat e konferencave ku zhvillohen aktivitete ndërinstucionale dhe ndërkombëtare, të cilat janë të pajisura me pajisje kompjuterike, monitorë, videoprojektorë, smartborde, hiteboards. <i>Ev.4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FB.pdf.</i> <i>Ev.Tabelat permbledhese per aneks RVB Ba Magb.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në vizitën në institucion, por edhe në dokumentacionin e vetëvlerësimit. GVJ konstatoi që Fakulteti Biznesit, i cili ofron programin e studimit, ofron për studentët laboratorë dhe gjithashtu salla dhe mjedise të tjera të pajisura me mjete brenda standarteve për të përmbushur kërkesat e programit dhe për të arritur objektivat e tij. Gjithashtu edhe një klasë hibride dhe një qendër për transferimin e teknologjive, të cilat janë në administrim dhe në funksion të programeve të studimit që ofron Departamenti i Agrobiznesit. <i>Ev.4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FB.pdf.</i> <i>Ev.4.4. Tabelë përmbledhëse e laboratorëve dhe përdorimi i tyre në mësimdhënie.pdf.</i> <i>Ev.Tabelat permbledhese per aneks RVB Ba Magb.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Fakulteti Bujqësisë, i cili ofron programin e studimit, ofron për studentët laboratorin e transferimit të teknologjive, laboratorin e informatikës, laboratorin fushor (EDE), laboratorin (klasa) hibride etj, ku studentët kryesisht realizojnë orët e seminareve për këtë program studimi. <i>Ev.4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FB.pdf.</i> <i>Ev.4.4. Tabelë përmbledhëse e laboratorëve dhe përdorimi i tyre në mësimdhënie.pdf.</i> <i>Ev.Tabelat permbledhese per aneks RVB Ba Magb.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht pasi bazuar në tërë dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion është konstatuar që UK ka në dispozicion të Fakultetit të Bujqësisë godinën e cila ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e

	nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit mësimorë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri të studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Gjithashtu UK vë në dispozicion të studentëve informacione on-line nga burime elektronike si ajo EIFL (Electronic Information for Library). <i>Ev.3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev.RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se në të dyja bibliotekat. Si në atë shkencore të UK por edhe në atë të Fakultetit të Bujqësisë raportojnë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit për të informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët, mbi botimet e fundit. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj të cilat shpërndahen si materiale shtesë me iniciativë të pedagogëve. GVJ konfirmoi në takim me stafin procesin e përditësimit të literaturës e cila inicohet nga kërkesat e tyre në njësinë bazë, e cila ndjek procesin më pas. <i>Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkangjitur RVB_së, kryesisht silabuseve, konstatohet se një pjesë dërrmuese e lëndëve të programit të studimit vijon të përdorë një literaturë të pa përditësuar me botime të viteve të fundit.</i> <i>Silabuset, një pjesë shumë e madhe prej tyre figurojnë të konceptuara e firmosura kryesisht nga titullarë të cilët nuk figurojnë të jenë pjesë PAE apo qoftë edhe PAK e departamentit të Agrobiznesit apo Fakultetit të Bujqësisë apo qoftë edhe të UK. Në një rast, në 6 lëndë figuron i njëjti titullar i lëndëve i cili nuk është as PAE e as PAK me këtë institucion të arsimit të lartë. Gjykojmë se ky mund të jetë një shkak pasojë e mos përditësimit të literaturës bazë të përdorur në silabuse specifike.</i> <i>Ev.2.7 Plani mësimor i programit të studimit.</i> <i>Ev.2.8 Programet lëndore të studimit.</i> <i>Ev.3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


	<i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që UK vë në dispozicion të studentëve dhe stafit një fond të përgjithshëm i cili arrin 17205 tituj (dhe 44042 kopje) në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një hapësirë studimi prej 562 m² si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve. Orari i shpallur gjatë ditëve të javës është 8:00-16:00. 1444 studentë dhe 270 pedagogë (me kohë të plotë dhe të pjesshme) kanë kartelat e tyre personale në këto biblioteka. <i>Ev. 3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni por edhe vizita në institucion sikurse e theksoj edhe në kriterin 3, se biblioteka disponon dhe një fond fond të përgjithshëm i cili arrin 17205 tituj (dhe 44042 kopje) në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një hapësirë studimi prej 562 m² si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve. <i>Ev. 3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi, që UK ofron për të gjithë dhe pa pagesë. Biblioteka ofron informacione online nga burime të ndryshme elektronike. Gjithashtu edhe nga burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Library). Biblioteka Shkencore e UK, duke qënë anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare, ka siguruar akses në burime të ndryshme elektronike, informacione të cilat mund të shfrytëzohen nga çdo student dhe pa pagesë. <i>Ev. 3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi, se Bibliotekat e UK s ofrojnë informacione online nga burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë. Biblioteka shkencore e UK dhe biblioteka e FB funksionojnë me salla studimi dhe të pajisura me kompjutera (internet) dhe video-projektorë duke iu dhënë mundësi studentëve për të punuar në mënyrë individuale dhe në grup duke bërë të mundur që numri i konsiderueshëm i posteve të punës në ambientet e bibliotekave, dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike, të mundësojë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.

	<i>Ev. 3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se Bibliotekat e UK operojnë sipas një rregulloreje dhe ofrojnë shërbim studentëve në orarin e vënë në dispozicion. Orari i shërbimit të bibliotekave, i shpallur gjatë ditëve të javës është: 8:00- 16:00. Për një kapacitet përdoruesish prej: 1444 studentësh. Me një hapësirë studimi prej 562 m² si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve. <i>Ev. 3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se stafi i punonjësve të bibliotekës është përgjegjës për raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës përkatëse. <i>Ev. 3.28 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga dokumentacioni në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programit. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Por GVJ rekomandon një përditësim të literaturës bazë më dinamike e të viteve të fundit në shumë programe të lëndëve në programin e studimit Bsc Menaxhim Agrobiznesi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se sekretaria e UK është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë takimit në sekretarinë mësimore u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe 1 dosje e zgjedhur studenti në programin Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi, të cilat rezultuan me informacion të plotë e të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi që përdoret është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre duke zëvendësuar sistemin elektronik ESSE3. Gjithashtu nëpërmjet projektit të shërbimeve të paketës Office 365 është mundësuar, komunikimi i stafit akademik dhe studentëve duke përfshirë: Komunikim nëpërmjet adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al. Përdorimin e Microsoft Teams për mësimin në distancë. <i>Ev.1.6 Marreveshja me RASH për sist elektronik PITAGORA.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.1.10 Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK.pdf.</i> <i>Ev.2.23 Raport instalimi i projektit Office 365.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në programin e studimit menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Ndërsa, Drejtoria e Financës posedon dhe përditëson informacionin në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, në funksion të përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me pagat. <i>Ev.1.4 Rregullorja e drejtorise juridike dhe burimeve njerezore.pdf.</i> <i>Ev.2.9 Jeteshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma apo sistemi ESSE3 i cili ka funksionuar deri më tani ka mundësuar efikasitet në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje të informacionit në kohë reale nga ana e studentëve, shërbime më të mira sekretarie që lehtësoi proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave, paraqitjen në rrjet të grafikut të provimeve, të rezultateve, krediteve, kurrikulës dhe programet lëndore. Rregullorja e këtij programi përcaktoi funksionet e sistemit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e personave të përfshirë. Ndërsa hyrja në sistem u mundësua edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit. Aktualisht UK ka



	nënshkruar marrëveshjen e re me RASH për përdorimin e sistemit të ri digjital "PITAGORA" duke zëvendësuar sistemin elektronik ESSE3. <i>Ev.1.6 Marrëveshja me RASH për sist elektronik PITAGORA.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma PITAGORA është sistemi që do të implementohet në UK i cili do të mbledhë, ruajë dhe përpunojë të dhëna për stafin dhe studentët, por GVJ konstatoi si nga RVB dhe nga vizita në institucion që stafi ka përdorur dhe sistemin elektronik ESSE3 si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët. UK gjithashtu publikon informacione në faqen e vet zyrtare të internetit e cila duhet të përditësohet vazhdimisht sidomos sa i përket programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Agrobiznesit. Programi i Transparencës, i instaluar në këtë faqe, pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik, administrativ dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë, etj. <i>Ev.1.6 Marrëveshja me RASH për sist elektronik PITAGORA.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.2.23 Raport instalimi i projektit Office 365.</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UK garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UK publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu në rrjetet sociale çdo fakultet dhe departament pasqyron informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. Megjithatë GVJ vren se në faqen web të Departamentit të Agrobiznesit, nuk është përditësuar informacioni për dy programet e studimit në ciklin e dytë të studimeve si dhe skedat përkatëse të programeve. <i>Ev.Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i> unkorce.edu.al/archive/programet_studimet/FB/index.php
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, UK përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë Universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UK. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, UK publikohet në faqen

	zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe. Megjithëse ka nevojë për përditësimin e ndonjë informacioni.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton se Departamenti i Agrobiznesit funksionon në përbërje të njësisë kryesore (Fakultetit të Bujqësisë), dhe padyshim është pjesë e njësisë së vetme shpenzuese të UK, pa pasuar buxhet të individualizuar në kuptimin e njësisë shpenzuese. Buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UK. Buxheti ndahet sipas përcaktimeve të rregullores financiare, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu hartimi i buxhetit të UK fillon nga njësia bazë, pra që nga departamenti, duke marrë parasysh nevojat e secilit prej tyre duke u varur edhe nga niveli i të ardhurave që pritet të realizojë çdo department. Ndërsa plani i financimit miratohet në nivel institucional nga Bordi i Administrimit ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e parashikuara. <i>Ev.1.7 Rregullore e Drejtorise Ekonomike.</i> <i>Ev.1.8 Rregullore e Drejtorise Financiare (EDE).</i> <i>Ev.1.8.1 Rregullorja financiare.pdf.</i> <i>Ev.4.2 Të dhëna financiare për kostot e programit të studimit.</i> <i>Ev.4.3 Model plani të financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.pdf.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se hartimi i planit të financimit të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit në “Menaxhim Agrobiznesi”, bazohet në strukturën buxhetore që përdoret për hartimin e buxhetit të shtetit, sipas zërave kryesorë buxhetorë: Shpenzime nga granti buxhetor, si dhe Shpenzimet nga të Ardhurat e veta. Në vijim plani i financimit të DA detajohet në mënyrë më analitike me gjithë elementët e shpenzimeve që parashikon për mbulimin e shpenzimeve operative, burimeve njerëzore, investimet për logjistikën dhe pajisjet. <i>Ev.4.3 Model plani të financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>

të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.				
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UK auditohet në mënyrë periodike nga tre hallka kryesore. Auditimi i brendshëm financiar nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit. Auditimi i jashtëm (i kryer në çdo dy vjet) nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si edhe nga auditimi i jashtëm, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut. <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UNIKO 2020-2021.</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e DVV, në fund të çdo viti rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve të UK. <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UNIKO 2020-2021.</i> unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UK është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UK janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Në rastet kur ka kërkesë të njësisë bazë dhe me miratim të organeve drejtuese të UK, në rastet kur nevojitet financim shtesë, apo përmirësim i situatës financiare, ri-planifikohen ndërhyrje të posaçme në zërat e shpenzimeve (apo në regjistrin e prokurimeve) për nevoja të ndryshimeve eventuale të financimit të programeve të studimeve, duke garantuar mbarëvajtje të veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor apo të programeve të studimit. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, UK përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UK. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet etj të UK publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe dhe në rrjetet sociale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UK, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e UK dhe FB specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.1.15 Raport i kontrollit të MASR për kapacitetin prote 2023-2024.pdf.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UK, GVJ konkludon se barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantojnë edhe nga ky institucion. Barazi kjo si në lidhje me regjistrimin ashtu edhe përgjatë studimeve, në lidhje me procesin e mësimdhënies, vlerësimit dhe me shërbimet mbështetëse që ofrohen në përputhje me Statutin e UK. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.1.15 Raport i kontrollit të MASR për kapacitetin prote 2023-2024.pdf.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>



Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe RVB, dhe pas vizitës në institucion, konstatoi që UK harton dhe bën publike kriteret dhe kuotat e pranimi për çdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Konstatohet se në programet e studimit të ciklit të parë të FB pranohen kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm, apo profesional, dhe kanë përfunduar jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Pranohen edhe kandidatët që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UK, procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të universitetit. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> unkorce.edu.al
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UK përveç komunikimit elektronik, për informimin e publikut shërbejnë dhe takimet me maurantët në ditë e informimit të maurantëve dhe aktiviteti që organizohet nga Fakulteti apo edhe Departamenti i Agrobiznesit. Universiteti menaxhon edhe forma informimi më të gjerë si Guida e Universitetit, broshura promocionale për programet e studimit dhe kriteret e pranimi, lajmërimet në media. Studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UK në rrjete sociale (FB dhe Instagram), mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> www.unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/programi_i_transparences.php

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se UK ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi i studimit nuk përjashton mundësinë e integritit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Në këtë program studimi parashikohen kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marxhinalizuara. <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.</i> <i>Ev.3.9 Shkresë nr. 75 prot, datë 18.01.2023 “Propozimi për kriteret e pranimit të studentëve 2023-2024”.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin rregullator të UK parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS. Pranohen edhe kandidatët që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar nga komisioni përkatës në MAS. Departamenti i Agrobiznesit çdo vit akademik propozon kritere të pranimit të studentëve për shtetas të huaj dhe vendas. <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.</i> <i>Ev.3.9 Shkresë nr. 75 prot, datë 18.01.2023 “Propozimi për kriteret e pranimit të studentëve 2023-2024”.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UK duke ndjekur dhe kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët e shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar sikurse është konsideruar gjithashtu edhe ky program studimi. <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, duke konstatuar se në kuadrin rregullator të UK parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet bachelor, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. UK ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UK, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit të Bujqësisë dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por UK aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve. Gjithashtu, studentët marrin informacione të hollësishme edhe pranë zyrës së informimit të studentëve dhe sekretarisë mësimore të departamentit. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UK përmes sekretarive të programeve të ciklit të parë dhe bazuar në rregullore të FB informon dhe orienton studentët në lidhje mundësinë për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njesisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, studentët marrin informacione të hollësishme edhe pranë zyrës së informimit të studentëve dhe sekretarisë mësimore të departamentit. <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i> <i>Ev.3.32 Model transferimi studentësh.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve. Studentët mund të marrin informacion të hollësishëm edhe pranë zyrës së informimit të studentëve, sekretarisë mësimore të departamentit, sekretarisë së sistemit. Nga programet lëndore të studimit konstatuam si GVJ nevojën për rishikimin e shpërndarjes së vlerësimit të vazhduar gjatë vitit të studentëve pasi është një përqindje e lartë e përcaktuar tek provimi përfundimtarë në pothuajse të gjitha lëndët (Nga 30/70 në 40/60). <i>Ev.2.8.2 Programet Lëndore të Studimit.</i> <i>Ev.1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore.</i>

	<i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita me studentet se studentët e programit të studimit, janë të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Diplomimi bëhet me mbrojtje e tezës së diplomës ose me provim formimi. Referuar rregullores së njësisë bazë, në fillim të semestrit të pestë, departamenti përcakton fushat e studimit, listën e temave të diplomës si dhe pedagogun udhëheqës. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Detyrime përmblylëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar dhe pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi. <i>Ev.2.2 Rregullore e Njësisë Kryesore.</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të UK, GVJ konstatoi se Departamenti i Agrobiznesit, në koordinim me strukturat e FB dhe UK, përfshirë edhe QKA, organizon takime informuese duke synuar dhënien e informacioneve të nevojshme në lidhje me elementët e përmbajtjes së programeve të studimit dhe nevojat e tyre të të nxënësve. UK organizon gjithashtu fushata promovuese me nxënësit e klasave të 10ta - 12ta në shkollat e mesme, harton broshurave informative dhe prezantime gjatë vizitave në to. https://unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyesi2020.pdf http://unkorce.edu.al/programet-e-studimit-2/ <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UK vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit. GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së vlerësimit të vazhduar gjatë vitit të studentëve pasi është një përqindje e lartë e përcaktuar tek provimi përfundimtarë në pothuajse të gjitha lëndët (Nga 30/70 në 40/60). UK, duke angazhuar staf të departamentit, organizon aktivitete informuese për studentët e interesuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit informohen nga Departamenti i Agrobiznesit mbi elementët e përmbajtjes së programeve të studimit dhe nevojat e tyre të të nxënit; organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Stafi akademik i FB dhe DA, është përfshirë në hartimin e planit strategjik të zhvillimit, rishikimin e kurrikulave, monitorimin e punës praktike të studentëve në institucionet e tregut të punës, në vlerësimin statistikor të regjistrimit të studentëve, si dhe në përditësimin e kriterëve të pranimit të tyre. <i>https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyesi2020.pdf. Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UK publikon faqen e vet zyrtare të internetit, e cila përditësohet vazhdimisht me informacion. Gjithashtu, programi i transparencës, pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë akademike, administrative dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë. GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në UK në kuadër të orientimit, ku më i rëndësishmit janë Ditët e Promocionit, ku ofrohet informacion mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si edhe aspekte të tjera të rëndësishme në lidhje me programin e studimit. <i>http://unkorce.edu.al/guida-UK/ http://unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/ Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit. Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Bujqësisë ka lidhur 24 marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për tju ofruar mundësi punësimi. Stafi akademik i FB dhe DA, në bashkëpunim me Qëndrën e Karrierës, në mënyrë sistematike, angazhohet në përpjekje konkrete që kanë të bëjnë me orientimin e studentëve në tregun e punës, në eksplorimin e mundësive dhe alternativave për administrimin e karrierës së tyre. DA realizon studim tregut të punës i cili ka siguruar një rrjet komunikimi institucional, që përfshin institucionet arsimore në rajon, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, njësitë administrative e bizneset private. <i>Ev.3.12.1 Strategjia e studimit të tregut të punës.pdf. Ev. Vizita në Institucion.</i>

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se Sekretariteti Mësimorë si dhe pedagogët e Departamentit të Agrobiznesit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik. Gjithashtu Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UK në rrjete sociale (FB dhe Instagram) mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime etj. <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e Njësisë Kryesore.</i> www.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit https://www.facebook.com/unkorce/posts/4095984270426262 <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se UK dhe FB kanë ngritur një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu ky informacion shpërndahet në rrjete sociale (FB dhe Instagram) shpallet në stenda dhe monitorë të dukshme në fakultet. <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> www.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf https://www.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419 <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht pasi konstatoi se në UK studentët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi, informohen nga pedagogët përkatës, sekretariteti dhe faqja zyrtare web e UK si edhe Sektori i Studimeve dhe TIK, për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. FB ka dhe rrit numrin e marrëveshjeve, duke ua vënë në dispozicion studentëve me qëllim orientimin e tyre drejt tregut të punës, gjithashtu kujdeset për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UK nëpërmjet Sektorit të Studimeve dhe TIK mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Gjithashtu është përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e platformës së sistemit dixhital të të dhënave të universitetit, si një mënyrë efektive dhe praktike komunikimi. <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.1.10 Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK.pdf.</i> <i>Ev.3.19 Model program i shkurtuar.pdf.</i> https://www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al/ www.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit																				
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se krahas sektorit të Studimeve dhe TIK i cili menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve, duke menaxhuar mbledhur, përpunuar, transmetuar dhe shfrytëzuar të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu edhe Sekretaria Mësimore mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore për regjistrimet e studentëve sipas programeve (në kursin/vitin e parë të studimeve), përfshi numrin e studentëve të regjistruar, numrin e të diplomuarve, numrin e studentëve që ndërpresin studimet. <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th><th>Të cregjistruar ve</th><th>Të diplomuarve</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>5</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>4</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>20</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Totali</td><td>29</td><td></td><td></td></tr></table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruar ve	Të diplomuarve	2020-2021	5	0	0	2021-2022	4	0	0	2022-2023	20	0	0	Totali	29		
Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruar ve	Të diplomuarve																		
2020-2021	5	0	0																		
2021-2022	4	0	0																		
2022-2023	20	0	0																		
Totali	29																				

	Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen personale dhe të ecures akademike të një studenti të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi dhe konstatoi plotësinë e tyre. <i>Ev.1.6 Marreveshja me RASH per sist elektronik PITAGORA.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.1.10 Rregullore e sektorit te studimeve dhe sektorit te TIK.pdf.</i> <i>Ev.2.13 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FB për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> <i>Ev.2.23 Raport instalimi i projektit Office 365.</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë</i> https://unk.pitagora.rash.al/login www.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimi <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UK dhe Fakultetit të Bujqësisë. Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve. Ai menaxhon mbledhjen, përpunimin, transmetimin dhe shfrytëzimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Ai koordinon mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre në bashkëpunim me sektorët e administratës në Rektorat. Sektori përpunon statistikën e të dhënave të ndryshme nga viti në vit dhe ua komunikon ato njësive përkatëse në universitet. Informacioni përcillet edhe në bazën e të dhënave të sistemeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve. Studentëve u jepet mundësia të regjistrohen (krijojnë llogari me user name dhe pasëord unik) në sistemin Pitagora. Në këtë sistem, ka të dhëna për studentët në nivel individual dhe hidhen të dhënat nga pedagogët në lidhje me vlerësimin e studentëve (gjatë vitit dhe në provime). <i>Ev.1.9 Rregullore per mbrojtjen, ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave personale.</i> <i>Ev.1.10 Rregullore e sektorit te studimeve dhe sektorit te TIK.pdf.</i> <i>Ev.2.23 Raport instalimi i projektit Office 365.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimor, sistemin e menaxhimit të brendshëm të	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UK kontrollon në mënyrë periodike në nivel fakulteti dhe universiteti të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse. Sektori i kurrikulës vlerësimi institucional dhe Alumni, është i përfshirë drejtpërdrejt në

informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	matjen e treguesve kyç të performancës dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Në Manualin e Cilësisë të UK përshkruhet e tërë veprimtaria e tij dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete, sekretariatë mësimore dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev.3.31 Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor.pdf.</i> <i>Ev.3.7 Raportet vjetore te NJSBC.pdf.</i> <i>Ev.3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (relacion).</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB por edhe dokumentacionit në DVV, njësia bazë “Departamenti i Agrobiznesit”, në mënyrë periodike, harton dhe analizon raporte analitike mbi ecurinë e veprimtarisë akademike e mësimore, ku ndër të tjera, evidentohen edhe aspekte që kanë të bëjnë me cilësinë, në hyrje dhe dalje të studentëve, dhe në lidhje me sfidat dhe mundësitë e punësimit të tyre. Njësia bazë mbështetet në këtë informacion për të realizuar analizat periodike. <i>Ev.2.13 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FB për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UK mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i UK mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UK në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundësuar ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

atyre rregullatore të vetë institucionit.	Akademik të UK, dhe në Bordin e Administrimit. Këshillat studentore në UK janë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstatoi se jo vetëm në statutin e UK por edhe në rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.24.1 Model - anëtarësimi i studentëve në Senatin Akademik.pdf.</i> <i>Ev.3.4 Lista e NJSBC.pdf.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstatoi se aktualisht UK përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor dhe stafin akademik. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. <i>GVJ konstatoi sidomos nga takimi me studentet të viteve të ndryshme se procedura elektronike e shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është e efikase dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë. Madje asnjë student prezent në takim me GVJ në nuk kishte plotësuar asnjë pyetësor.</i> <i>Në takimin me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Sektori i Kurrikulës u ngrit ky si shqetësim në lidhje me pjesëmarrjen minimale të studentëve në pyetësor. Si GVJ e shikojmë me shumë rëndësi plotësimin në sasi të konsiderueshme nga studentët të pyetësorit. Rekomandojmë ndryshimin e formës së plotësimit të tyre, duke u realizuar në auditor ndoshta edhe në mënyrë tradicionale në mënyrë të printuar me letër.</i> <i>Ev.1.1 Statuti i UK.</i> <i>Ev.1.17 Rregullorja e Këshillit Studentor.pdf.</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev.3.13 Pyetësori i NJSBCS pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor.</i> <i>Ev.3.14 Te dhëna nga pyetësoret me studentet.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e programit të studimi, GVJ konstatoi se në çdo fund

të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. <i>Proces ky që (nga takimi me studentët) nuk është shumë i qartë dhe nuk ishte realizuar, GVJ konstatoi edhe nga takimi me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Sektorin e Kurrikulës se nuk ka pjesëmarrje të lartë nga ana e studentëve dhe kjo krijon një mungesë të rëndësishme të informacionit në drejtim të cilësisë.</i> <i>Ev.3.13 Pyetësi i NJSBCS pas sezonit në bashkëpunim me keshillin studentor.</i> <i>Ev.3.14 Të dhëna nga pyetësit me studentet.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UK ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Bordin e Administrimit si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni përdor edhe pyetësin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. GVJ konstatoi se procedura elektronike e shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është efikase dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë të studentëve. Madje konstatoam se asnjë student pjesëmarrës në takim me GVJ nuk ka plotësuar asnjë pyetësor. Rekomandojmë ndryshimin e formës së plotësimit të tyre, duke u'a realizuar në auditor ndoshta edhe në mënyrë tradicionale në mënyrë të printuar me letër.</i> <i>Ky fakt ndikon ndjeshëm vlerësimin e cilësisë prandaj edhe GVJ e konsideron këtë standard të përbushur pjesërisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstatoi se UK është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), duke mundësuar, në këtë mënyrë përdor sistemin "Pitagora" si një sistem dixhital në shërbim të studentëve. UK gjithashtu nëpërmjet projektit të instalimit të shërbimeve të paketës Office 365 u mundësua komunikimi i stafit akademik dhe studentëve duke përfshirë komunikim nëpërmjet adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al. Por një tjetër rrugë komunikimi kanë qënë edhe rrjetet sociale, të gjitha këto forma kanë mundësuar informimin në kohë reale të të gjithë palëve të interesit mbi aktivitetin e UK.

	<i>Ev.1.6 Marreveshja me RASH per sist elektronik PITAGORA.</i> <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.1.10 Rregullore e sektorit te studimeve dhe sektorit te TIK.pdf.</i> <i>Ev.2.23 Raport instalimi i projektit Office 365.</i> https://unk.pitagora.rash.al/ http://unkorce.edu.al/guida-UK/ http://unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/ <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se në UK dhe FB është ngritur një sistem i organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor. I gjithë informacioni i detajuar në lidhje me programet e studimit të ofruara, stafin akademik, kurrikulën, rezultatet e të nxënës, kurset dhe rezultatet e provimeve, paraqitet në llogaritë personale të çdo studenti në platformën dixhitale Pitagora. Sektori i Studimeve dhe TIK si edhe sekretaria mësimore garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët. <i>Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Ev.2.13 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FB për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> www.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf https://www.unkorce.edu.al/tarifet-e-sherbimeve <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bazuar në informacionin në RVB por edhe në dokumentacionin në DVV, GVJ konstaton se NJSBC e UK vazhdimisht përdorin mjete për të vlerësuar përparimin e studentëve. UK gjithashtu nëpërmjet Qendrës së Karrierës, ka krijuar profilin e një ure lidhëse mes tregut dhe UK duke aplikuar në Platformën GRADUA, me anë të së cilës synon përditësimin e vazhdueshëm të njoftimeve për vende të reja pune. Qendra gjithashtu njofton në kohë reale studentët e diplomuar (dhe ata aktualë) për çdo njoftim që vjen nga Zyra e punës. Por duhet të kemi në konsideratë se programi Menaxhim Agrobiznesi nuk ka nxjerrë akoma të diplomuar që nga ri_organizimi i programit. Sa i takon orientimit në praktika profesionale dhe tregut të punës. UK ka ndihmuar në drejtim të marrëveshjeve që ka me 24 Institucione dhe Organizata bashkëpunuese. <i>Ev.2.24 Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA.pdf.</i> https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyesi2020.pdf http://www.graduaproject.com/ <i>Ev. Tabelat permbledhese per Aneks RVB.</i>

	<i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional & Alumni dhe Qendra e Karrierës organizojnë trajnime dhe aktivitete të ndryshme me studentët, ku diskutohet dhe orientohen studentët, mbi zhvillimin e karrierës, hartimin e CV-ve dhe përpilimin e dosjes personale, prezantimin gjatë intervistave të punës. Gjithashtu studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UK në rrjete sociale (FB dhe Instagram) mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, njoftime etj., <i>Ev.2.21 Gjurmimi Alumni.pdf.</i> <i>Ev.3.10 Praktika e organizimit të tryezave të përbashkëta me operatorët e sektorit privat.pdf.</i> <i>Ev.3.12.1 Strategjia e studimit të tregut të punës.pdf.</i> <i>Ev.4.5 Materiale promovuese.pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> https://facebook.com/unkorce/posts/5058027830888563, https://graduaproject.com/gradua-project/?lang=sq http://graduaproject.com/			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se Sekretaria Mësimore dhe zyra e Karrierës dhe ALUMNI-t janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Qendra Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në UK, e cila gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UK, GVJ konstatoi se UK i ka strukturat dhe procedurat të mirëpërcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Këto struktura janë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UK. <i>Ev.1.16 Manuali i cilesise se UNIKO.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët, UK monitoron në vazhdimësi proceset, veprimtaritë, burimet njerëzore dhe kontekstin në të cilin realizohet misioni i tij si një qendër arsimore dhe kërkimore. Treguesit kryesorë të performancës maten përmes hartimit të raportit të vetëvlerësimit, monitorimit të vazhdueshëm të dokumentacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të rolit të stafit dhe studentëve në sigurimin e cilësisë, përmes anketave dhe pyetësorëve, përcaktimit të rekomandimeve për përmirësim dhe ndjekjes në vijimësi të masave të ndërmarra. <i>GVJ konstatoi se procedura elektronike të shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është efikase dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë të studentëve. Madje konstatoam se asnjë student pjesëmarrës në takim me GVJ nuk ka plotësuar asnjë pyetësor. Rekomandojmë ndryshimin e formës së plotësimit të tyre, duke u'a realizuar në auditor ndoshta edhe në mënyrë tradicionale në mënyrë të printuar me letër.</i> Vlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies kryhet nëpërmjet pyetësorit të përgjithshëm i cili zhvillohet nga NjSBC në bashkëpunim me Këshillin Studentor. Performanca e stafit akademik vlerësohet në kuadër të arritjeve në fushën e akademike dhe kërkimore të gjithsecilit nëpërmjet analizave në përfundim të një moduli, si dhe gjatë analizave vjetore të departamentit sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë. <i>Ev.1.16 Manuali i cilesise se UNIKO.</i> <i>Ev.3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (relacion).</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i> <i>Ev.3.13 Pyetësori i NjSBCS pas sezonit në bashkëpunim me keshillin studentor.</i> <i>Ev.3.17 Model analiza në përfundim të një moduli.pdf.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Kuadri rregullator i UK u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UK. <i>Sikurse e kemi identifikuar si anomali mos plotësimin në masë të pyetësorit (konstatim i dalë nga takimi GVJ me studentët ku ata që ishin present madje pranuan se nuk kishin plotësuar pyetësor) ndoshta për shkak të formës elektronike të shpërndarjes nga ana e studentëve</i>


	<i>rekomandojmë që të ndërrojë forma dhe periudha e plotësimit të pyetësorit.</i> <i>Ev.3.13 Pyetësi i NjSBCS pas sezonit ne bashkepunim me keshillin studentor.</i> <i>Ev.3.14 Te dhena nga pyetesoret me studentet.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UK. GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve janë diskutuar në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente; synimi është nxitja e diskutimit në lidhje me nevojën për përmirësimin e kurrikulës, metodave të mësimdhënies apo infrastrukturës në të cilën ajo zhvillohet. Në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. <i>Ev.3.13 Pyetësi i NjSBCS pas sezonit ne bashkepunim me keshillin studentor.</i> <i>Ev.3.14 Te dhena nga pyetesoret me studentet.</i> <i>http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e RVB dhe DVV, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues të NJSBC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të personelit duke u bërë pjesë e mbledhjeve në dekanat dhe departament, ka si qëllim dhe diskutimet konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Nga UK stafi akademik mbështetet të kryejë studime brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet vitit sabbatik, si dhe nxitet të marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta diskutimesh dhe në trajnime, që janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve ndërkombëtare ku universiteti është pjesë. UK promovon stafin akademik nëpërmjet organizimit të veprimtarive që prezantojnë për një publik më të gjerë kontributin akademik dhe shoqëror të kërkimit shkencor të stafit të tij. <i>Ev.1.21 Rregullorja per vitin sabbatik.pdf.</i> <i>Ev.2.9.1 Certifikata pjesëmarrjeje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani.</i> <i>Ev.2.20 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik & Institutit kërkimor-shkencor CIHEAM.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet kryesisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UK u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe</i>

	<i>parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. Por pjesmarrja e studentëve në realizimin e pyetësorëve, të konfirmuar nga vet ata në takim me GVJ ka qënë pothuajse inekzistente duke pranuar se nuk kanë plotësuar pyetësorë. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri dhe realizimi i tyre është esencial në funksion të menaxhimit të cilësisë, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni. GVJ rekomandon angazhimin e institucionit për ndryshimin e periudhës dhe formës së realizimit të pyetësorëve ndoshta nga elektronik me formë hard copy e të printuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në planin strategjik 2022-2027 të UK, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë. Në FB siguri i brendshëm i cilësisë realizohet sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin XI të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FB “Vlerësimi i cilësisë “ku specifikohen procedurat dhe strukturat për vlerësimin e cilësisë. Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UK dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <i>Ev.1.16 Manuali i cilesise se UNIKO.</i> <i>Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UNIKO.pdf.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.21 Gjurmimi Alumni.pdf.</i> <i>Ev.3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (relacion).</i>



	<i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GJVJ konstatoi se UK ka krijuar strukturat e brendshme, proceset dhe udhëzimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ka në përbërje një njësi të posaçme që merret me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe me bashkërendimin e procedurave që synojnë përmirësim të vazhdueshëm. Sektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e planeve për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UK dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës në fakultete, dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve dhe organeve drejtuese të universitetit, për masat që duhet të ndërmerren. <i>Ev.1.16 Manuali i cilesise se UNIKO.</i> <i>Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UNIKO.pdf.</i> <i>Ev.2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore e FB.</i> <i>Ev.2.21 Gjurmimi Alumni.pdf.</i> <i>Ev.3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (relacion).</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucion GJVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UK realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Në UNIKO Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional është pjesë e administratës së rektoratit të UK. Ky organ gjeneron procedura, propozon marrjen e masave dhe monitoron realizimin e tyre me qëllim përmirësimin e standardeve të ofertës akademike të UK_së. <i>Ev.1.16 Manuali i cilesise se UNIKO.</i> <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë.pdf</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GJVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualin e UK dhe FB paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie (moment ky që kemi dhënë konstatimin tonë për realizimin më të mirë të tij). Rezultatet e treguesve të performancës, (pjesë e raporteve vjetore të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore), diskutohen në fund të çdo viti, në takimet e organizuara me anëtarët e stafit akademik të departamentit, me fokus promovime nxitëse për

	arritjet më të mira në programin e studimit. <i>Ev.3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në UK procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ndërkohë, UK ka marrë akreditimin institucional si dhe programi i studimit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi është në proces akreditimi për herë të parë pas riorganizimit.</i> <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve (të cilët kanë një nevojë organizimi ndryshe në funksion të vjeljes së informacionit, pasi interesimi i realizimit të tyre elektronikisht është shumë i ulët nga ana e studentëve. Prandaj lipset nevoja e ndryshimit të formës së bërjes si edhe periudhës), për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecursisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe RVB se FB, bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore, duke angazhuar komisionin <i>ad-hoc</i> për rishikimin e programeve të studimit dhe rregulloreve përkatëse. UK përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregulloreve të studimit. <i>Ev.2.13 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FB për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> <i>Ev.3.12 Studim tregu për programin e studimit "Menaxhim Agrobiznes"</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e	GVJ konstatoi nga RVB si edhe dokumentat e DVV se raportet e analizës vjetore të mësimit dhe punës kërkimore shkencore që kryhet në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe IAL-je. Të cilat përfshijnë performancën e stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent të saj, qoftë atë mësimor apo kërkimor si dhe formimin profesional të studentëve.

marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Këto raporte përmbledhin evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. <i>Ev.2.13 Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FB për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> <i>Ev.3.12 Studim tregu për programin e studimit "Menaxhim Agrobiznes"</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i> <i>http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe RVB se UK vlerësimi i treguesve të performancës, të realizimit apo mbarëvajtjes së programeve të studimit, bazohet në metodologji e cila synon matjen/vlerësimin e indikatorëve sasiore dhe cilësorë, lidhur me programet e studimit që ofron njësi bazë mbi procesin mësimor, performancën e stafit akademik, studentët, organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë mbështetëse etj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bazohet në të dhënat që përfitohen nëpërmjet anketimit të studentëve. Gjithashtu, janë aplikuar edhe orë të hapura leksionesh nga pedagogë me tituj shkencorë (profesorë dhe titullarë lëndësh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie), me qëllim ofrimin e përvijës së tyre në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies nga ana e lektorëve të rinj. <i>Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UK</i> <i>Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit".</i> <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit (bachelor) në "Menaxhim Agrobiznesi" 2022-2025.pdf</i> <i>Ev.3.14 Te dhëna nga pyetësoret me studentet.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Bazuar në informacionin e DVV dhe RVB, GVJ konstatoi se programet e studimit në UK i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet instrumentave të tërthorta të NJBSC-së, organeve vendimmarrëse, stafit akademik dhe studentëve. Këto instrumenta rezultojnë të jenë kompleks: Sjellja dhe veprimtaria e stafit akademik matet edhe me të dhëna e pyetësorëve të studentëve, intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në FB, për të vlerësuar programet e studimit. GVJ vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi. <i>Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit (bachelor) në "Menaxhim Agrobiznesi" 2022-2025.pdf</i> <i>Ev.3.14 Te dhëna nga pyetësoret me studentet.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>

Konkluzione	GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UK parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësore dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. UK së fundmi ka pasuruar kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e Cilësisë specifikohen funksionet e të gjitha strukturave që nga Senati Akademik dhe deri tek pedagogët. <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.10.2 Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.</i> <i>Ev.2.25 Vendimi për krijimin e bordit këshillimor dhe funksionimi i tij.</i> <i>Ev.3.10 Praktika e organizimit të tryezave të përbashkëta me operatorët e sektorit privat.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Statuti i UK thekson organizimin strukturor të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet rrjetit të cilësisë apo DKVIA e ngritur në nivel IAL-je si dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UK. <i>Ev.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej	GVJ vlerëson se UK garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik




përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. <i>Kujtojmë këtu nevojën e organizimit ndryshe të pyetësorëve të studentëve në funksion të vjeljes së informacionit, pasi interesimi i realizimit të tyre elektronikisht është shumë i ulët nga ana e studentëve.</i> <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vlerëson se UK nëpërmjet DKVIA, në bashkëpunim me njësitë bazë si edhe SKVIA garanton procesin e sigurimit të cilësisë është gjithëpërfshirës, transparent, i diskutuar me stafet dhe i bazuar në formate e procedura të miratuara dhe të bëra publike. Pranë FB është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi. Kjo njësi funksionon në respektim të plotë të integritetit të aktorëve. <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev.1.19 Kodi i Etikes se UNIKO.pdf.</i> <i>Ev.3.14 Te dhena nga pyetesoret me studentet.</i> <i>Ev.3.7 Raportet vjetore te NJSBC.pdf.</i> <i>Ev.3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (relacion).</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UK angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe institucioneve të jashtme që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Ky bashkëpunim konsiston në ndihmë të procesit të realizimit të praktikave mësimore-profesionale, FB ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me operatorë të sektorit privat si dhe me institucione të ndryshme rajonale, duke u përpjekur t'i përfshijë ata, në diskutime dhe shkëmbim opinionesh, me synim përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programeve të studimit. <i>Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.10.2 Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.</i> <i>Ev.3.10 Praktika e organizimit te tryezave te perbashketa me operatoret e sektorit privat.</i> <i>Ev.3.12 Studim tregu per programin e studimit "Menaxhim Agrobiznes".</i>
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UK përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. (megjithëse këtu theksojmë nevojën e organizimit ndryshe të pyetësorëve të studentëve në funksion

	të vjeljes së informacionit, pasi interesimi i realizimit të tyre elektronikisht është shumë i ulët nga ana e studentëve). Përmes aktiviteteve si, leksione të hapura me biznese private por edhe personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UK realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UK parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti dhe përfshijnë një sërë dokumantash që janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme. <i>Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO.pdf.</i> <i>Ev.2.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi të FB.</i> <i>Ev.2.10.2 Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimet në faqen zyrtare Web të UK dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Gjithashtu rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, diskutohen në takimet e organizuara në nivel departamenti, në të cilën merren masat për përmirësimin e dobësive. <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstatoi se FB, në bashkëpunim me departamentet (përfshi edhe DA), në fillim të çdo viti akademik miraton një plan veprimi aktiviteteve, të cilat kanë të adresuara dhe synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara nga proceset e vetëvlerësimit dhe marrjes së rezultatit në vitin paraardhës, me qëllim përmirësimin e ecures së programeve të studimit për vitin e ri akademik. <i>Ev. Vizita në Institucion.</i> <i>Ev. RVB Ba Magb.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UK realizohen periodikisht analiza gjithashtu si edhe në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. Raportet

në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	e veprimtarisë së DA përmbajnë jo vetëm analizën e ecurisë dhe arritjet por gjithashtu japin dhe rekomandimet përkatëse për përmirësim të nevojshme. <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se takimet e organizuara në nivel të Njësive Kryesore (FB) dhe të Njësive Bazë (DA) ofrojnë informacione të nevojshme tek stafi akademik mbi arritjet, mangësitë dhe problematikat, lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore, në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme të cilësisë së personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës. <i>Ev.2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2020-2021.</i> <i>Ev. Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se UK publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në
“Menaxhim Agrobiznes.” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan
S Noli”, Korçë**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Trashëgimia e prodhimit bujqësor dhe agrobiznesit në e Rajonin e Korçës, këto veçori tradicionale krijojnë një bazë të fortë për zhvillimin e programit të studimit në Menaxhim Agrobiznesi.
2. Programi i studimit mbështetet nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar në fusha që lidhen direkt me nevojat e tij.
3. Angazhimi i personelit akademik në projekte të ndryshme të Erasmus Plus për ndërtimin e kapaciteteve siguron përditësimin e informacionit me çështjet e kohës në fushën e bujqësisë, dhe ekonomisë, si edhe përmirëson cilësinë e programit të studimit duke sjellë praktika dhe njohuri të reja.
4. Praktika e rishikimit dhe analizimit të vazhdueshëm të programit të studimit komunikon ecurinë e tij tek palët e interesuara. Ky proces siguron që programi të përmbushë objektivat e vendosura dhe të adresojë nevojat e kohës.
5. Numri i konsiderueshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit me tipologji të ndryshme organizatash, të cilat mundësojnë që programi i studimit të sigurojë një bazë solide për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion të vazhdueshëm.

Pika të dobta:

1. Ngarkesa mësimore në ore dhe numër lëndësh e personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në këtë program studimi, është e lartë dhe jo në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi. *(Standarti 4.1, kriteri 2)*
2. Mungesa në njësinë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, e personelit akademik të kategorisë “Profesor”, gjë që reflektohet edhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, ku një pjesë e madhe e tyre janë firmosur e konceptuar nga Profesorë të cilët nuk janë as personel akademik me kohë të plotë e as me kohë të pjeshme e njësisë bazë apo institucionit. *(Standarti 4.1, kriteri 2)*
3. Formati i syllabuseve të një pjese dërrmuese të lëndëve të këtij programi studimi dhe literatura e përdorur në to është e pa përditësuar dhe jo në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi *(Standarti 2.4, kriteri 5)*
4. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se procedura elektronike e shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është efikase dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë të studentëve. *(Standarti 5, kriteri 3 dhe 4)*
5. Një pikë e dobët në programin e studimit është kategorizimi i lëndëve, i cili kërkon rishikim dhe rishpërndarje për të siguruar një grupim të saktë të lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, dhe lëndëve ndërdisiplinore. *(Standarti 2.1, kriteri 4)*

Rekomandime:

Eicopa

[Signature]

1. Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës mësimore në ore dhe numër lëndësh të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi.
2. Institucioni, të marrë masa që titullarët e lëndëve të këtij programi studimi të jenë personel akademik me kohë të plotë apo me kohët të pjesshme i vetë institucionit dhe ti përkasin kategorisë Profesor.
3. Institucioni, të rishikojë formatin dhe përditësojë literaturën e përdorur në syllabuset e këtij programi studimi, në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi.
4. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm GVJ konstatoi se procedura elektronike të shpërndarjes së pyetësorëve të studentëve dhe mbledhja e informacionit nuk është efikase dhe nuk siguron pjesëmarrje të lartë të studentëve. Rekomandojmë ndryshimin e formës së plotësimit të tyre, duke u'a realizuar në auditor ndoshta edhe në mënyrë tradicionale në mënyrë të printuar me letër.
5. Në funksion të kategorizimit të lëndëve të programit të studimit, rekomandohet rishikimi dhe rishpërndarje të grupimit si të lëndëve bazë, lëndëve karakteriuese ashtu edhe lëndëve ndërdisiplinore. Duke ju referuara praktikave më të mira të programeve të ngjashme, si edhe rishikimin e krediteve të praktikës profesionale, për të qënë në përputhje me parashikimet nënligjore.
6. GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së vlerësimit të vazhduar gjatë vitit të studentëve pasi është një përqindje e lartë e përcaktuar tek provimi përfundimtar në pothuajse të gjitha lëndët (nga 30/70 në 40/60).

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Agribusiness Management" provided by the Higher Education Institution "University Fan S Noli Korça"

Strengths and affirmations


1. The heritage of agricultural production and agribusiness in the Korça region, with these traditional features, creates a strong foundation for developing the study program in Agribusiness Management.
2. The study program is supported by qualified and trained staff in fields directly related to its needs.
3. Academic personnel's engagement in various Erasmus Plus projects for capacity building ensures that information is updated with current issues in agriculture and economics and improves the quality of the study program by introducing new practices and knowledge.
4. The practice of continuous review and analysis of the study program communicates its progress to stakeholders. This process ensures that the program meets established objectives and addresses current needs.
5. The considerable number of cooperation agreements with various organizations enables the study program to secure a solid foundation for sustainable development and continuous innovation.

Weaknesses

1. The teaching load in hours and the number of courses for full-time academic staff engaged in this study program is high and not in accordance with current sub-legal provisions. **(Standard 4.1, Criterion 2).**

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	



2. The lack of "Professor" category academic staff in the base unit responsible for offering this study program is reflected in the syllabi of the courses in this program, where a large part of them are signed and designed by Professors who are neither full-time nor part-time academic staff of the base unit or institution. *(Standard 4.1, Criterion 2).*
3. The format of the syllabi of a significant portion of the courses in this study program and the literature used in them is outdated and not in accordance with current sub-legal provisions. *(Standard 2.4, Criterion 5).*
4. The External Evaluation Group found that the electronic procedure for distributing student questionnaires and collecting information is not efficient and does not ensure high student participation. *(Standard 5, Criterion 3 and 4).*
5. A weakness in the study program is the categorization of courses, which requires review and redistribution to ensure accurate grouping of core courses, characteristic courses, and interdisciplinary courses. *(Standard 2.1, Criterion 4).*

Recommendation

1. The institution should take measures to reduce the teaching load in hours and the number of courses for full-time academic staff engaged in this study program, in accordance with current sub-legal provisions.
2. The institution should ensure that the course professors of this study program are full-time or part-time academic staff of the institution itself and belong to the Professor category.
3. The institution should review the format and update the literature used in the syllabi of this study program, in accordance with current sub-legal provisions.
4. The External Evaluation Group (EEG) found that the electronic procedure for distributing student questionnaires and collecting information is not efficient and does not ensure high student participation. We recommend changing the method of completing them, possibly conducting it in the classroom, even using traditional printed paper.
5. For the categorization of courses in the study program, it is recommended to review and redistribute the grouping of core courses, characteristic courses, and interdisciplinary courses. Referring to best practices of similar programs, as well as reviewing the credits for professional practice, to be in accordance with sub-legal provisions.
6. The EEG recommends reviewing the distribution of continuous assessment throughout the year for students, as a high percentage is determined by the final exam in almost all courses (from 30/70 to 40/60).